



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 22/33 prot.

Tiranë më, 13.02.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. EDMOND ALI RIZAJ

Nr. 12, datë 13.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Erjana Pjetri	Kryesuese
Ersa Karaj	Relatore
Klevis Dhigoi	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Lediana Azemaj, më datë 13.02.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Edmond Ali Rizaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Hetimit për Krimin e Organizuar, në Departamentin e Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Ersja Karaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Edmond Ali Rizaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit (05.04.2023), si Drejtor i Drejtorisë së Hetimit, në Departamentin e Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, z. Edmond Ali Rizaj, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 01, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: znj. Erjana Pjetri (Kryesuese), znj. Ersja Karaj (Relatore) dhe z. Klevis Dhigoi (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr. 22/2 prot., datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Edmond Ali Rizaj.

6. Relatori i çështjes, Znj. Ersa Karaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore më datë 24.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Edmond Rizaj, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklarimit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Formularin e Kontrollit të Figurës, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara Ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;

- d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI-së Nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklaramit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaramit;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Trupa e Vlerësimit, më datë 21.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Rizaj me Vendimin Nr. 03, datë 21.12.2023, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Ali Rizaj.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 24.01.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.

17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 13.02.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimi Edmond Ali Rizaj ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij Ligji, ka për objekt deklarinë dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të

tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

22. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Edmond Rizaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 06.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi 3, viti 2023.
23. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërisë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.
26. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Deklaratat e interesave private për të gjithë periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit.

- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme.
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim.
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

29.1 Edmond Rizaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2003
- Periodike/Vjetore 2004
- Periodike/Vjetore 2005
- Periodike/Vjetore 2006
- Periodike/Vjetore 2007
- Pas Largimit nga Funkzioni 2008
- Para fillimit të detyrës 2009
- Periodike/Vjetore 2009
- Periodike/Vjetore 2010
- Periodike/Vjetore 2011
- Periodike/Vjetore 2012
- Pas Largimit nga Funkzioni 2013
- Para fillimit të detyrës 2021
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022

29.2 ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative; ka dërguar një raport të hollësishëm nr. *** prot., datë 31.07.2023, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Rizaj, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me Ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, EDMOND ALI RIZAJ

PASURI TË PALUAJTSHME

1) **Apartament 83.4 m²** sipërfaqe ndërtimi, ndodhur në adresë: Njësia nr. **, Rruga “Androkli Kostallari”, Ndërtesa **, Hyrja **, Ap.**, Tiranë.

Burimi i krijimit: kredituar nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 2002. Afati i shlyerjes 25 vite dhe përfundojnë pagesat në vitin 2027.

Vlera: 1.605.084 lekë

Pjesa në %: (subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese në deklaratën e pasurisë).

Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë Kontratë shitje me këste me kusht, nr. *** Rep., nr. ** Kol., datë. 08.02.2002, për apartament banimi në bashkëpronësi me sipërfaqe ndërtimi 83.4 m², e cila përbëhet nga 72.55 m² sipërfaqe shfrytëzimi, si dhe nga 3.8 m² sipërfaqe e përbashkët, në vlerën 1.605.084 lek. Palë blerëse Edmond Rizaj dhe Migena Rizaj dhe palë shitëse Drejtoria Rajonale e Entit të Banesave Tiranë.

HETIMI ADMINISTRATIV

30. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrin Noterial, FSHU, 14 Shoqërive Rajonale Ujësjellës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u janë drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

30.1 ASHK Tiranë - DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Jug, DV Tirana Rurale 1, DV Kamëz Vorë, DV Tiranë Rurale 2, me shkresat nr. *** prot., datë 12.06.2023, datë 16.06.2023, datë 26.06.2023 dhe datë 29.06.2023, drejtuar ILDKPKI-së, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Edmond Rizaj dhe personave të lidhur.

30.2 Nga Regjistri Noterial rezultoi se subjekti i vlerësimit Edmond Rizaj ka:

- a. Kontratë të përkohshme për shitje apartamenti banimi datë 02.06.2000, ndërmjet Degës së Entit Kombëtar të Banesave dhe Z. Edmond Rizaj, përmendur nga subjekti në inventarin nr.*** prot., datë 21.06.2023 në ILDKPKI dhe përcjellë si akt nga vetë ai, i cili rezulton i njëjtë.
- b. Kontratë Shitje me këste me kusht, nr.*** Rep., nr.*** Kol., datë 08.02.2002, për apartament banimi në bashkëpronësi me sip. ndërtimi 83.4 m², e ndodhur në Rr. “Blloku Sizmik”, seksioni **, ap. **, Tiranë, përmendur nga vetë subjekti në deklaratën e pasurisë dhe përcjellë si akt nga vetë ai, i cili rezulton i njëjtë.

30.3 FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 18.05.2023, konfirmon se në emër të Edmond Rizaj, figuron një kontrate furnizimi me nr. TR***** në instancën Tiranë.

30.4 Shoqëria Rajonale e Ujësjetës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot, datë 17.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

30.5 14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës - Kanalizime, me shkresat nr. *** - *** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

30.6 Në lidhje me përgjigjen e ardhur nga UKT, ku konfirmohet se nuk ka asnjë kontratë me UKT në emër të tij dhe personave të lidhur, subjekti i vlerësimit ka sqaruar se ka kontratë me numër *****, zona **, por personeli ka gabuar duke shënuar emrin Edmond RIZAI (dhe jo Rizaj), e pavarësisht se prej vitesh u ka kërkuar me shkrim ta korrigjojnë mbiemrin, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Subjekti ka dorëzuar:

- a. Librezë me OSHEE në emër të Edmond Rizaj, nr. kontratë *****, me adresë rr. “Don Bosko”.
- b. Librezë me UKT, në emër të Edmond Rizaj, nr. kontratë *****, me adresë rr. “Don Bosko”, *duke bashkëlidhur edhe modulën e konsultimit të informacionit online, nga UKT.*

30.7 Nga sa më sipër, Trupa e Vlerësimit vëren se kontrata e furnizimit e lidhur me FSHU me nr. TR**** në instancën Tiranë, rezulton e njëjtë me librezën e OSHEE të vënë në dispozicion nga subjekti i vlerësimit si dokumentacion shoqëruës.

30.8 Sipas dokumentacionit shoqëruës të përcjellë nga subjekti i vlerësimit, konfirmohen të dhënat në librezën e UKT Tiranë.

30.9 Gjithashtu, përsa i përket adresës së apartamentit të deklaruar nga subjekti në Rr. “Androkli Kostallari”, nga kërkimi në google maps konfirmohet kjo adresë në zonën Don Bosko, Tiranë, në përputhje me të dhënat në librezat me FSHU dhe UKT.

31. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, (referuar statementit bashkëlidhur CD) konfirmon shlyerjet e kësteve të kredisë për Entin e Banesave nga llogaria e Edmond Rizaj në shumën 5.200 lekë/muaj, nga muaji shtator 2011 e në vazhdim.

32. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim edhe dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga subjekti më datë 21.06.2023 pranë ILDKPKI-së, konkretisht:

- a. Vërtetim nr. *** prot, datë 14.06.2023, nga Enti Kombëtar Banesave, ku konfirmohet se me Z. Edmond Rizaj, është lidhur kontratë shitje me kusht nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 08.02.2002, për apartamentin e ndodhur në rrugën “Blloku Sizmik”, seksioni **, ap. **, Tiranë. Çmimi i shitjes së apartamentit është llogaritur në vlerën 1.558.672 lekë.
- b. Kontratë e përkohshme për shitje apartamenti banimi, datë 02.06.2000, ndërmjet Degës së Entit Kombëtar të Banesave dhe Z. Edmond Rizaj, apartament 2+1 në Rr. "Blloku Sizmik",

sek.** , apt. **, Tiranë. Blerësi përpara nënshkrimit të kontratës detyrohet të paguajë shumën 35.000 lekë paradhënie. M.A nr.***, datë 02.06.2000.

33. Trupa vëren se:

33.1 Vlera me të cilën është lidhur kontrata e shitjes së apartamentit, është **1.621.991 lekë**, nga të cilat blerësi ka paguar 63.319 lekë me mandatet e arkëtimit nr. ***, datë 02.06.2000 dhe nr. ***, datë 06.02.2002, duke bërë që në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes me kusht nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 08.02.2002, shuma e kredisë së dhënë nga shteti të mbetet në vlerën **1.558.672 lekë**.

33.2 Kredia e dhënë nga shteti me afat 25 vjeçar (2002-2027) paguhet me këste në masë mujore 5.200 lekë, ku përfshihet edhe llogaritja e interesit.

34. Referuar të dhënave nga nxjerrja e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, si dhe duke u bazuar në deklaratimet periodike të interesave private të subjektit, Trupa e Vlerësimit verifikoi pagesat mujore (prej 5.200 lekë) dhe llogaritit detyrimin e shlyer nga subjekti i vlerësimit deri më datë 01.03.2023, ku konfirmohet vlera prej 1.310.400 lekë. Pra, më datë 01.03.2023, subjektit i mbeten për të paguar 248.272 lekë.

35. Vlera e apartamentit sipas kontratës së shitjes, shpenzimet operacionale, kreditimi i apartamentit për çdo vit, si dhe detyrimi i mbetur për t'u paguar, janë paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën e mëposhtme.

	2000	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total
PASURI																								
Apartament me sipërfaqe *** m ² , ndodhur në ****	1,621,991																							
DETYRIME																								
Kreditimi i apartamentit nga EKB (2002-2027)	1,558,672																							
Shpenzime operacionale	63,319																							
Shlyerje e kredisë		52,000	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	10,400	1,310,400
DETYRIMI I MBETUR	1,558,672	1,506,672	1,444,272	1,381,872	1,319,472	1,257,072	1,194,672	1,132,272	1,069,872	1,007,472	945,072	882,672	820,272	757,872	695,472	633,072	570,672	508,272	445,872	383,472	321,072	258,672	248,272	

36. Trupa e Vlerësimit, nga hetimi administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaratimit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, vëren se për pasurinë e trajtuar më sipër:

- ✓ Subjekti ka deklaruar vleftën e apartamentit ndërtuar/blerë në shumën 1.605.084 lekë duke iu referuar kontratës së shitjes me këste nr. *** rep. dhe nr. ** kol., datë 08.02.2002.
- ✓ Ka patur burime të ligjshme financiare për të shlyer kredinë e pasurisë.
- ✓ Subjekti vazhdon të ketë detyrime kredie ndaj EKB në shumën 284.272 lekë.

PASURI TË TJETËRSUARA

2) **Apartament 65.8 m²**, ndodhur në adresën Njësia nr.** , Rruga “Sitki Çiço”, Ndërtesa **, Hyrja **, Apartamenti ** Tiranë.

Shitur: me çmim 36.000 euro. Shuma e përfituar nga subjekti 18.000 euro.

Pjesa takuese: 1/2.

Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues:

- a. Kontratë Shitje Pasuri e Paluajtshme, nr. *** Rep., *** Kol., datë 03.04.2017 për apartamentin me nr. pasurie ***, ZK ***, vol. **, fq. ***, me sipërfaqe 65.8 m², rruga “Sitki Çiço”, Tiranë, në vlerën 36.000 euro. Palë shitëse Edmond Rizaj dhe G. R.
- b. Certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar në datë 07.02.2011.
- c. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 18.10.2010, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.
- d. Autorizim nga Komiteti Ekzekutiv i KP Lagjes nr.2, Tiranë, datë 20.08.1984, lëshuar Ali Rizaj, për strehimin e tij dhe familjes së tij në apartamentin 65.8 m², ndodhur në Rr. “Sitki Çiço”.

HETIMI ADMINISTRATIV

37. Subjekti i vlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të tjetërsuar në rubrikën “Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, pasi të ardhurat nga shitja e apartamentit i kanë shërbyer si burim të ardhurash/kursimi për të krijuar pasuri të tjera të deklaruara nga subjekti në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, konkretisht për llogarinë bankare në monedhën euro pranë Raiffeisen Bank. Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti deklaron “*të gjitha pasuritë e akumuluar... në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit...*” në rubrikën “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit” të deklaratës së pasurisë dhe për këtë arsye apartamenti i shitur nga subjekti do të trajtohet fillimisht si pasuri e tjetërsuar.

37.1 Apartamenti me sipërfaqe 65.8 m², ndodhur në Njësinë nr. ***, rruga “Sitki Çiço”, Tiranë, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka qenë një pronë e regjistruar në emër të A. R. dhe T. R. (prindërit e subjektit) të cilët e kanë përfituar nëpërmjet privatizimit. Me ndërrimin jetë të prindërve, kjo pasuri i është nënshtruar procedurave të pasurisë trashëgimore.

37.2 Nga administrimi i Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 18.10.2010, rezulton se Edmond Rizaj dhe G. R. janë trashëgimtarët ligjorë të rradhës së parë për trashëgimlënësit A.R. dhe T. R.

37.3 Nëpërmjet kartelës së pasurisë u bë i mundur evidentimi i bashkëpronarëve të kësaj pasurie trashëgimore. Pra, sikurse konfirmohet nga certifikata për vërtetim pronësie, lëshuar në datë 07.02.2011, dorëzuar nga subjekti i vlerësimit në datë 23.06.2023 pranë ILDKPKI-së, apartamenti 65.8 m², ndodhur në Rr. “Sitki Çiço”, përfituar nga Dëshmia e Trashëgimisë, ishte në bashkëpronësi me pjesë të barabarta nga subjekti dhe vëllai i tij G. R.

37.4 Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, rezulton se shtetasit B.S. dhe T.S., nën cilësinë e blerësit, kanë nënshkruar kontratën e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme, nr. *** rep., *** kol., më datë 03.04.2017, me palën shitëse Edmond Rizaj dhe G. R. Çmimi i shitjes së apartamentit është 36.000 euro, prej të cilave subjekti i vlerësimit ka përfituar 50 % të tij (36.000 euro x ½ = 18.000 euro).

37.5 Sipas shkresës nr.*** prot., datë 8.5.2023 nga **Raiffeisen Bank**, është konfirmuar kreditimi i shumës 17.926 euro në llogarinë rrjedhëse në monedhën euro të Edmond Rizaj në datë 10.04.2023, nga shitja e pasurisë sipas kontratës nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 03.04.2017. Gjithashtu, rezulton se nga shuma 17.926 euro, subjekti ka tërhequr 3.300 euro në datë 11.04.2017 dhe 5.500 euro janë transferuar nga subjekti në llogarinë e vëllait G. R., në datë 14.04.2017.

37.6 Për shumën e transferuar në llogarinë e vëllait të tij prej 5.500 euro, subjekti i vlerësimit ka sqaruar se në kushtet kur i ndjeri vëllai i tij, G. R., ishte në gjendje më të dobët ekonomike, vendosi t'i dhurojë një shumë prej 5.500 euro, nga pjesa takuese e tij.

37.7 Ndërsa për destinacionin e shumës 3.300 euro të tërhequr nga llogaria e tij, subjekti ka deklaruar se e ka tërhequr pa ndonjë qëllim konkret dhe e ka mbajtur në shtëpi cash.

38. Nga hetimi administrativ i kryer mbi këtë pasuri të paluajtshme të tjetërsuar nga subjekti dhe vëllai i tij, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

✓ **Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur mbi përfitimin e apartamentit me dëshmi trashëgimie nga prindërit A.T. dhe T. R., si dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, lidhur me shitjen e pasurisë dhe kalimin e shumës 17.926 euro, prej të cilave 5.500 euro ia ka dhuruar vëllait dhe 3.300 euro i ka tërhequr nga llogaria për t'i mbajtur cash.**

3) **Autovetura Renault Laguna**, me targë TR***, e blerë më datë 01.05.2004, nga shtetasi M. Z. (EL***) dhe shitur shtetasit A. S. në datë 18.04.2010.

Çmimi i blerjes: 3.200 Euro.

Burimi i krijimit: 200.000 lekë marrë kredi në Procredit Bank (Maj 2004, me afat shlyerje 2 vite, 10.200 lekë/muaj) dhe pjesa tjetër me kursime.

Vlera e shitjes: 350.000 lekë

Subjekti ka bashkëlidhur:

- a. Kontratë Blerje automjeti nr. *** rep., nr.*** kol., datë29.12.2008. Automjet Renault Laguna, me targë EL***, nr. shasie ****, në vlerën 3.200 Euro. Palë blerëse Edmond Rizaj.
- b. Kontrate Shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë18.04.2010. Automjet Renault Laguna me targë TR***, nr. shasie VF***, në shumën 350,000 lekë. Palë shitëse Edmond Rizaj.
- c. Nxjerrje llogarie nga Procredit Bank, në emër të Edmond Rizaj, në monedhën lekë.
- d. Nxjerrje llogarie nga Procredit Bank, në emër të Edmond Rizaj, në monedhën euro.

e. Nxjerrje llogarie nga Procredit Bank, në emër të Edmond Rizaj, në monedhën USD.

HETIMI ADMINISTRATIV

39. Subjekti i vlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të tjetërsuar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”. Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti ka detyrimin të deklarojë *“të gjitha pasuritë e akumuluar... në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit...”*. Kjo pasuri e luajtshme do të trajtohet këtu (deklarimi i pasurive) duke verifikuar dhe vlerësuar burimin e krijimit dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për blerjen e autoveturës, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë.

40. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon automjetin e deklaruar.

40.1 Referuar deklaramit të subjektit të vlerësimit rezulton se autovetura Renault Laguna, me targë EL*** dhe nr. shasie VF***, është blerë në datë 01.05.2004 në vlerën 3.200 Euro, ndërkohë që bashkëlidhur këtij deklarami, subjekti ka dorëzuar kontratën e blerjes së automjeti nr. *** rep., nr.*** kol.. të nënshkruar më datë 29.12.2008.

40.2 Nga momenti i krijimit të pasurisë, sipas deklaramit të subjektit (1 Maj 2004), deri në datën e nënshkrimit të kontratës së blerjes më datë 29.12.2008, nuk rezulton të ketë pasur ndonjë marrëveshje me shkrim midis palëve.

40.3 I pyetur për këtë mospërputhje, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim pranë ILDKPKI-së se: *automjeti është marrë nga ana e tij në vitin 2004, por kontrata e shitblerjes është bërë në 29.12.2008, pasi shtetasi M. Z. ishte rezident në Itali dhe kur ai ka ardhur në Shqipëri për pushime është bërë dhe Kontrata e Shit-blerjes.*

40.4 Gjithashtu, në përgjigjen dërguar Relatores së Trupës së Vlerësimit nëpërmjet email-it të datës 11.12.2023, subjekti ka shtuar shpjegime të tjera si vijon:

- *“M.Z. ishte pronari “de juro” i mjetit, i cili jetonte si emigrant në Itali. Në fakt, pronari de facto i automjetit është F. S., administrator i subjektit tregtar “FLOBEST 2003 SHPK”, i cili ja kish blerë dhe ishte likuiduar financiarisht me pronarin “de juro” M. Z., por nuk kishin bërë një kontratë për shkak të mos prezencës së tij në Shqipëri. F.S. ishte shok i afërt i ish-shefit të Komisarariatit të Policisë Rrugore në atë kohë, z. D. M. (në rolin e ndërmjetësit dhe garantit).*
- *Likuidimin e 3.200 Euro subjekti deklaroi se e ka bërë pas rreth një muaji të marrjes fizikisht të automjetit (mbajtur në provë për rreth një muaj), por kontrata është bërë vetëm pasi pronari “de juro” ka ardhur në Elbasan për pushimet e fund vitit.*
- *Gjithashtu, deklaroi me përgjegjësi se mjeti ka qenë nën posedimin e tij që në fillim të muajit Maj 2004 (periudhë të cilën e mban mend pasi ishte koha që është transferuar nga Drejtoria*

e Policisë së Qarkut Tiranë, drejtor në Institutin e Policisë, dhe i duhej patjetër një automjet për të shkuar në punë”.

41. Nga kontrolli i kryer, Trupa e Vlerësimit verifikoi se subjekti i vlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të paluajtshme në “*Deklarimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” në vitin 2004, nga ku konfirmohet deklarim i njëjtë përsa i përket llojit të mjetit, targës, vlerës dhe datës së krijimit të pasurisë.

41.1 Në lidhje me pasaktësinë në emrin e shitësit të automjetit, nga krahasimi i bërë me deklarimin vjetor të ILDKPKI-së, është konsideruar si një “lajthitje në të shkruar” nga ana e subjektit në kthim-përgjigjen e tij nëpërmjet e-mailit të datës 11.12.2023.

42. Në lidhje me burimin e krijimit dhe likuidimin e shumës 3.200 euro, e cila ka shërbyer për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, sipas kontratës së blerjes së automjetit Renault Laguna nr.*** Rep, datë 29.12.2008, rezulton se Edmond Rizaj ka blerë këtë pasuri me çmimin e cilësuar 3.200 euro, ku citohet se është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

42.2 Sipas kursit mesatar të lekut kundrejt euros për muajin Maj 2004, çmimi i blerjes së automjetit rezulton afërsisht 408.384 lekë (127.62 lekë/euro x 3.200 euro).

42.3 Për burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se ka shërbyer kredia e marrë prej 200.000 lekë në Procredit Bank (21.05.2004, me afat shlyerje 2 vite, 10.200 lekë/muaj), si dhe kursimet familjare.

42.4 Procredit Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në monedhën lekë në emër të Edmond Rizaj, për periudhën 2003 - 2010. Konfirmohet disbursim kredie në datë 21.05.2004, në shumën 200.000 lekë. Llogaria është mbyllur në datë 24.05.2006.

42.5 I pyetur mbi mënyrën e pagesës dhe kohën e kryerjes së saj, nëpërmjet email-it të datës 12.12.2023, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime se ka aplikuar për kredinë në momentin që ka marrë automjetin, ndërsa koha e lëvrimit të kredisë nga Procredit Bank ka qenë datë 21.05.2004, sikurse vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë bankare. Me marrjen e kredisë, subjekti ka paguar pronarin “de facto” F. S., duke shtuar se “*I gjithë operacioni i shit – blerjes, dhënia e parave etj., ishte në raporte besueshmërie absolute, pasi ishte z. D. M., shok i të dyja palëve, (në cilësinë e ndërmjetësit dhe garantit)*”.

43. Në mbështetje të deklarimeve të sipërpërmendura, me email-in e datës 18.12.2023 subjekti;

- Ka deklaruar se të gjitha raportet i ka patur me F.S., ndërsa shtetasin M.Z. e ka parë vetëm tek zyra e noteres, gjatë kohës që nënshkruan kontratën e shit-blerjes së automjetit.
- Ka bashkëlidhur Deklaratën Noteriale të shtetasit F. S. me nr. *** repertori dhe nr. *** koleksioni, datë 18.12.2023.

- c. Ka nënvizuar faktin se, nuk ka njohuri për anën teknike të mjeteve, sikurse dhe nuk është i prirur për t'u marrë me shit-blerje, ndaj u ka kërkuar asistencë teknike shokëve.

44. I pyetur nga relatorja mbi kontratën e shitblerjes së automjetit ku thuhet se likuidimi do të kryhet pas nënshkrimit të kontratës (pra pas datës 29.12.2008), ndërkohë që sipas deklarimeve të subjektit kjo pagesë është kryer në vitin 2004, (kur ka marrë në dorëzim mjetin); nëpërmjet e-mail-it të datës 18.12.2023, subjekti është shprehur se, sipas gjykimit të tij, është një lapsus (gabim material) i noteres, pasi në tre herë të tjera, ajo ka shprehur se pagesat janë bërë përpara dhe nuk ka detyrime ndërmjet palëve.

45. Trupa e Vlerësimit, kreu analizën financiare për periudhën 2001-2006 për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të, mbi mundësinë për kursim për krijimin e kësaj pasurie dhe mundësinë e shlyerjes së kredisë së marrë, duke llogaritur për çdo vit të ardhurat nga paga dhe shpërblymimet të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij, shpenzimet jetike sipas INSTAT dhe shpenzimet për pagesë kredie (principal + interesa), sipas tabelës bashkëlidhur këtij relacioni.

46. Në lidhje me shitjen e kësaj pasurie, nga verifikimet e kryera, Trupa e Vlerësimit konstatoi se autovetura i është shitur A. S., sipas Kontratës së shitblerjes së automjetit nr.*** rep., nr.*** kol., datë 18.04.2010 kundrejt vleftës 350.000 lekë, shumë e cila është likuiduar përpara redaktimit të kontratës, në përputhje me deklaratimet dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit.

46.1 Të ardhurat e krijuara nga shitja e kësaj pasurie kanë shërbyer si burim i pjesshëm krijimi për pasurinë e luajtshme Autovetura Opel Vectra, me targë TR***, blerë më 29.09.2009.

47. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në sqarimet me shkrim të subjektit mbi krijimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme Autoveturë Renault Laguna, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

47.1 *Automjeti tip Renault Laguna, në pronësi të subjektit, është blerë në vitin 2004 nga shtetasi F. S. me kredi nga Procredit Bank (Maj 2004) dhe me kursime familjare, ndërkohë që kontrata e blerjes është lidhur në vitin 2008 me pronarin "de juro" M. Z.. Autovetura i është shitur A. S. më datë 18.04.2010 kundrejt vleftës 350.000 lekë.*

➤ **Subjekti ka patur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe për shlyerjen e kredisë së marrë për këtë qëllim.**

➤ **Konfirmohet shitja me dokumentacionin e dorëzuar.**

4) **Autovetura Opel Vectra**, me targë TR***, blerë më datë 29.09.2009, nga shtetasi N. S., me Kontratë nr. *** rep. dhe nr. *** kol.

Çmimi i blerjes: 7.200 Euro.

Burimi i krijimit: 3.200 Euro nga shitja e automjetit Renault Laguna TR*** dhe pjesa tjetër me kursime.

Vlera e shitjes: 5.000 Euro; shitur në vitin 2019 Personit Fizik “P. Th.”.

Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin justifikues:

- a. Kontratë Blerje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol., datë 29.09.2009. Automjet Opel Vectra, me targë TR***, në vlerën 7.200 Euro. Palë blerëse Edmond Rizaj.
- b. Kontratë Shitje automjeti nr. ***rep, nr. *** kol., datë16.08.2019. Automjet Opel Vectra me targë TR ***, në shumën 5.000 euro. Palë shitëse Edmond Rizaj.

HETIMI ADMINISTRATIV

48. Subjekti i vlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të tjetërsuar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”. Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti ka detyrimin të deklarojë “*të gjitha pasuritë e akumuluar... në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit...*”. Kjo pasuri e luajtshme është trajtuar sipas rubrikës “deklarimi i pasurive” duke verifikuar dhe vlerësuar burimin e krijimit dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për blerjen e autoveturës, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë.

49. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon automjetin me targë AA*** me targë të mëparshme TR *** në pronësinë e Edmond Rizaj.

50. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, si dhe nga sqarimet e dhëna nëpërmjet korrespondencës së mbajtur me relatorin e çështjes, Trupa e Vlerësimit vëren se:

50.1 Automjeti Opel Vectra, me targë TR *** i është blerë shitësit N. S. më datë 29 Shtator 2009 në vlerën 7.200 euro, sipas kontratës së shitblerjes për pasurinë e luajtshme Nr.*** rep., dhe Nr.*** kol., datë 29.09.2009.

50.2 Në deklaratën e pasurisë së tij, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit Renault Laguna me targë TR *** (3.200 Euro) dhe pjesa tjetër me kursime.

50.3 Me inventarin nr.extra prot., datë 21.06.2023, subjekti ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së sqarime me shkrim se, si burim për blerjen e automjetit Opel Vectra në vitin 2009, ka shërbyer një kredi e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2008, në shumën 700.000 lekë. Blerja nuk është realizuar këtë vit, por në vitin 2009, ku ka marrë një Opel Vectra, të përshkruar në deklaratimet e tij.

50.4 Subjekti ka bashkëlidhur Kontratë Kredie Bankare, datë 16.07.2008, nga Raiffeisen Bank, me kredi marrës Edmond dhe Migena Rizaj në shumën 700.000 lekë, me qëllim përdorim personal.

50.5 I pyetur nga Relatorja mbi këtë mospërputhje mbi burimin e krijimit, nëpërmjet email-it të datës 18.12.2023, subjekti ka dhënë shpjegime se: “*e ka deklaruar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, pasi nuk ka dashur të konfondohen të ardhurat vjetore (2008 me 2009) me njëra-*

tjetrën. Në këtë këndvështrim, kredinë e marrë në vitin 2008, duke qenë se nuk e kishte shpenzuar dot për qëllimin e marrjes, në deklarinimet e vitit 2009 e ka konsideruar si pjesë të kursimeve, ashtu siç ishte në fakt, pjesë e të hyrave të pashpenzuara nga 2008”.

50.6 Subjekti ka shtuar se ka përdorur sistemin e kredive bankare, si një mënyrë të leverdishme, sa herë që donte të bënte investime relativisht të mëdha në shtëpi, pra jo se nuk ka patur të ardhura apo kursime familjare. Ky deklarinim konfirmohet edhe nga verifikimet që ka kryer Trupa e Vlerësimit në lidhje me kreditë e marra ndër vite nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

51. Referuar të dhënave të nxjerra nga Kontrata e Kredisë Bankare, datë 16.07.2008, mbi shumën 700.000 lekë, si dhe duke u bazuar në statement bankar të përcjellë nga Raiffeisen Bank, Trupa e Vlerësimit llogariti dhe verifikoi të gjitha shpenzimet e kryera për pagesën e kredisë, nga ku rezultoi se subjekti i vlerësimit ka shlyer të gjitha detyrimet e tij kundrejt Raiffeisen Bank në shumën totale prej 999.177 lekë (duke përfshirë dhe interesat) gjatë periudhës 2008-20013.

52. Trupa e Vlerësimit, kreu analizën financiare mbi mundësinë për kursim për krijimin e kësaj pasurie dhe mundësinë e shlyerjes së kredisë së marrë, duke llogaritur për çdo vit të ardhurat nga paga dhe shpërblimet të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij, shpenzimet jetike sipas INSTAT, dhe shpenzimet për pagesë kredie (principal + interesa). *Shiko shtojca 1.*

53. Në lidhje me shitjen e kësaj pasurie, nga verifikimet e kryera, Trupa e Vlerësimit konstatoi se autovetura Opel Vectra, me targë TR *** i është shitur Personit Fizik “Pajtim Thaçi”, sipas Kontratës së Shitjes së Automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.08.2019 kundrejt çmimit 5000 Euro, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale, në përputhje me deklarinimet dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit.

54. Në përfundim të hetimit administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarinimit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit vëren se:

- ✓ **DPSHTRR konfirmon blerjen dhe shitjen e automjetit me dokumentacionin e dorëzuar.**
- ✓ **Subjekti ka patur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kredisë së marrë për këtë qëllim.**

5) **Autoveturë tip Volkswagen Jetta** me targë AA****.

Çmimi i blerjes: 5.000 Euro

Vlera e shitjes: 8.500 Euro, subjektit Tirana International School.

Subjekti ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.08.2022

HETIMI ADMINISTRATIV

55. Subjekti i vlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të tjetërsuar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”. Bazuar në nenin 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti ka detyrimin të deklarojë “*të gjitha pasuritë e akumuluar... në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit...*”. Kjo pasuri e luajtshme është sipas rubrikës “deklarimi i pasurive”, duke verifikuar e vlerësuar burimin e krijimit dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për blerjen e automjetit, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë.

56. **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon automjetin me targë AA***, në pronësinë e Edmond Rizaj.

56.1 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin bashkëlidhur praktikës së përcjellë nga DPSHTRR, si më poshtë vijon:

- a. Faturë Tatimore shitje nr.***, datë.14.08.2019, me palë blerëse Edmond Rizaj. Autoveturë Volkswagen Jetta, në shumën 5.500 Euro.
- b. Akt Shitje nga Erjon Auto, datë 14.08.2019. Automjet Volksagen Jetta, nr. Shasie ****, në shumën 5.500 euro. Palë blerëse Edmond Rizaj.
- c. Kontratë Shitje automjeti nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 20.8.2022. Palë shitëse Edmond Rizaj dhe palë blerëse Tirana International School. Automjet Volkswagen Jetta, nr. shasie **** me targë AA****, në shumën 8.500 euro.

57. ***Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas analizës financiare të kryer nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se subjekti ka patur mundësi kursimi të mjaftueshme për blerjen e automjetit.***

58. Nga aktet e administruara, Trupa e Vlerësimit vëren se çmimi i shitjes së automjetit me targë AA**** (*shitur në datë 20.08.2022, në shumën 8,500 euro*) është më i lartë në krahasim me çmimin e blerjes së automjetit nga subjekti i vlerësimit (*blerë në datë 14.08.2019, në shumën 5.500 euro*), me një diferencë prej 3.000 euro.

58.1 I pyetur në lidhje me shumën e përfituar nga shitja e automjetit me targë AA*** me inventarin nr.extra prot., datë 21.06.2023 në ILDKPKI, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se autovetura është blerë në Kanada, e përplasur dhe ka ardhur këtu në atë gjendje. Pasi është riparuar, i ka shtuar autoveturës impiantin e gazit, që së bashku me tarifat e kontrollit teknik dhe regjistrimit të ndryshimeve të karakteristikave konstruktive ose funksionale të mjetit, ka rritur ndjeshëm vlerën e autoveturës. Gjithashtu ka sqaruar, se kur është blerë automjeti ka pasur rreth 71.082 km, pra thuhet e re dhe është shitur po me 86.552 km të bëra, pra konsiderohet shumë e re.

58.2 Në mbështetje të deklaramit dhe sqarimeve të dhëna prej tij mbi rritjen e vlerës së shitjes së automjetit në krahasim me çmimin e blerjes, subjekti i vlerësimit ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues:

- a. Certifikatë “Miratim i ndryshimit të karakteristikave konstruktive ose funksionale të mjetit rrugor” të lëshuar nga Shpresa-AI, me nr.****, datë 29.08.2019, ku konfirmohet miratimi i ndryshimit të karakteristikave teknike të mjetit me targë AA***, nga "benzinë" në " benzinë + gaz".
- b. Procesverbal mbi kontrollin dhe testimin e mjetit datë 29.08.2019, bashkëlidhur faturë tatimore mbi kontrollin e kryer.
- c. Foto ilustruese të automjetit, ku janë të evidentuara dëmtimet e tij nga përplasja, si dhe numrin e kilometrave që zotëron në datë 12.04.2019.

59. Në lidhje pagesën e tatim fitimit për shitjen e autoveturës, pas marrjes së relacionit paraprak, më datë 21.12.2023, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se kjo pagesë është bërë pas dorëzimit të formularëve të Vetting, konkretisht më datë 15.03.2023, duke bashkëlidhur kopje të faturës së pagesës së tatim fitimit nga shitja e automjetit.

60. Në përfundim të hetimit administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

- **Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR, lidhur me blerjen dhe shitjen e automjetit tip Volkswagen Jetta.**
- **Ka patur burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.**
- **Subjekti ka kryer pagesën e tatim-fitimit për të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.**

GJENDJE NË LLOGARI BANKARE

- 6) Gjendje **9.000 euro**, në Raiffeisen Bank.
- 7) Gjendje **2.000 USD**, në Raiffeisen Bank
- 8) Gjendje **410.000 lekë**, në Raiffeisen Bank.

Burimi i krijimit:

- a. Shitje e apartamentit të trashëguar nga prindërit, shtetasve B.T. dhe T. S., apartament 65.8 m², ndodhur në adresën; Njësia nr.**, Rruga “Sitki Çiço” Ndërtesa **, Hyrja **, Apartamenti **, Tiranë. Shitur me çmim 36.000 euro, pjesa takuese 50 %. Pasuria nr. **, ZK **, kontrata nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë 03.04.2017.
- b. Kursime në vite nga të ardhurat nga pagat, shpërblimet, etj.

HETIMI ADMINISTRATIV

61. Subjekti i vlerësimit i ka deklaruar këto tre gjendje të llogarive bankare në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” dhe jo në Rubrikën “Deklarimi i Pasurive dhe Burimi i krijimit”. Megjithatë, subjekti ka plotësuar në mënyrë të saktë llojin e pasurisë, vlerën dhe burimin e krijimit për këto tre gjendje llogarish bankare.

62. Sikurse është deklaruar nga vetë subjekti i vlerësimit, të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të sipërcituar, kanë shërbyer si burim të ardhurash/kursimi për të krijuar një pasuri tjetër, konkretisht gjendjen e llogarisë rrjedhëse në monedhën Euro, pranë Raiffeisen Bank.

63. Shitja e apartamentit të përfituar me dëshmi trashëgimie nga prindërit A.T. dhe T. R. dhe pjesë takuese $\frac{1}{2}$ e vlerës së shitur ($36.000 * \frac{1}{2} = 18.000$ euro) është trajtuar **hollësisht në rubrikën më sipër “Pasuri të tjetërsuara”**, ku në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Subjekti i vlerësimit ka përfituar të ardhura nga shitja e apartamentit në vlerën 17.926 Euro, të derdhura në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank në monedhën Euro, prej të cilave 3.300 Euro i ka tërhequr për t'i mbajtur cash dhe 5.500 euro ia ka dhuruar të vëllait G. R..

64. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të subjektit Edmond Ali Rizaj në datë 06.03.2023 (data e dorëzimit të deklaratës së pasurisë):

a. Llogari rrjedhëse në monedhën euro, me balancë 9.000 euro.

65. Nga nxjerrja dhe verifikimi i kësaj llogarie, konfirmohet kreditimi i shumës 17.926 Euro në datë 10.04.2017, nga shitja e pasurisë sipas kontratës nr. *** rep. nr. *** kol., datë 03.04.2017, si dhe debitimi i shumave 5.500 euro dhe 3.300 euro nga subjekti i vlerësimit, në përputhje me dokumentacionin, deklaratimet dhe sqarimet e përcjella nga vetë subjektit.

b. Llogari rrjedhëse në monedhën USD, me balancë 2.000 USD.

66. Nga nxjerrja dhe verifikimi i kësaj llogarie, konfirmohet kreditimi i të ardhurave nga United Nations, në datë 28.06.2022, në shumën 1.136 USD dhe nga subjekti në datë 22.2.2023, shuma 864 USD.

66.1 Nga korrespondenca me ILDKPKI-në dhe Relatoren e Trupës së Vlerësimit, subjekti ka dhënë sqarime/shpjegime mbi burimin e krijimit të kësaj llogarie, duke bashkëlidhur dhe dokumentacionin justifikues që vërteton pjesëmarrjen e subjektit në projektin e OKB-së, në Qershor 2022, konkretisht kopje të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që ka miratuar udhëtimin dhe shpenzimet.

c. Llogari page, me balancë 577.053 lekë dhe Overdraft, me balancë -150.000 lekë.

67. Nga nxjerrja e llogarisë së pagës pranë Raiffeisen Bank, Trupa e Vlerësimit ka kontrolluar dhe verifikuar të ardhurat nga paga dhe shpërblime nga punësimi të subjektit të vlerësimit, për periudhën Prill 2005 – Shkurt 2023, nga ku rezulton se këto të ardhura janë në shumën totale rreth 21.806.657 lekë, ndërsa balanca e llogarisë në datë 06.03.2023 është 577.053 lekë.

67.1 Mbi këtë ndryshim të gjendjes së llogarisë së deklaruar nga subjekti dhe asaj të konfirmuar nga banka, subjekti i vlerësimit ka dhënë sqarime me shkrim pranë ILDKPKI-së me inventarin nr.extra prot., datë 21.06.2023, ku ka sqaruar se shuma 410.000 (katërqind e dhjetë mijë) lekë, e rrumbullakosur, (që saktësisht është 410.613) është gjendja në bankë, më datë 25.02.2023. Më datë 02.03.2023, është kredituar paga dhe një shpërblim, në shumën 176.440 lekë, duke shkuar shuma 577.053 lekë. **Kjo është edhe shifra e saktë e gjendjes së llogarisë më datë 06.03.2023.**

68. Nga hetimi i kryer, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarimit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- Llogaria me gjendje 9.000 euro është krijuar gjatë periudhës 2017 - shkurt 2023.
- Llogaria me gjendje 2.000 USD është krijuar gjatë periudhës prill 2013 - shkurt 2023.
- Llogaria e pagës me gjendje në shumën 410.000 lekë është krijuar gjatë periudhës 2005 - shkurt 2023.

✓ **Konfirmohet deklarimi lidhur me llogarinë në Euro dhe USD (dollarë amerikan), me përgjigjen në RFZ Bank.**

✓ **Subjekti dha sqarime dhe paraqiti dokumentacion, lidhur me gjendjen e llogarisë së pagës.**

✓ **Subjekti ka patur burime të ligjshme për krijimin e këtyre llogarive bankare.**

GJENDJE CASH

9) **Cash: 12.500 Euro**

Burimi i krijimit: 8.500 euro nga shitje autoveturë tip Volkswagen JETTA, me targë AA***, subjektit Tirana International School, Kontratë nr. *** Rep. dhe nr. *** kol., datë 20.08.2022, Akt Shitje Pajtim Thaçi NIPT *****, datë 14.08.2019.

Shuma 4.000 euro, kursime në vite nga pagat, shpërblimet.

HETIMI ADMINISTRATIV

69. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar gjendjen cash në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, duke plotësuar në mënyrë të saktë llojin e pasurisë, vlerën dhe burimin e krijimit për këtë gjendje cash.

69.1 Në lidhje me burimin e krijimit, të ardhurat nga shitja e automjetit Volkswagen Jetta, në vlerën 8.500 euro, **janë trajtuar më sipër në mënyrë të hollësishme.**

69.2 Për të kontrolluar mundësinë për kursim në shumën 4.000 euro (nga të ardhurat ndër vite nga pagat dhe shpërblimet), Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare sipas tabelës bashkëlidhur këtij relacioni. *Shiko shtojca 1.*

69.3 Nga hetimi i kryer, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

➤ **Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.**

DEKLARIM I TË ARDHURAVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, EDMOND ALI RIZAJ

- 1) Të ardhura nga puna si oficer policie, përfshirë (pagat, shpërblime, dieta, kompensime për veshje), për periudhën 01.01.2023 deri 01.03.2023, në shumën 212.612 lekë.
- 2) Të ardhura nga puna si oficer policie, përfshirë (pagat, shpërblime, dieta, kompensime për veshje), për periudhën 01.01.2006 deri 31.12.2022, në shumën 22.824.775 lekë.
- 3) Të ardhura nga puna si oficer policie, përfshirë (pagat, shpërblime, dieta, kompensime për veshje), për periudhën 01.01.2004 deri 31.12.2005, në shumën 1.818.625 lekë.
- 4) Të ardhura nga puna si oficer policie dhe funksionar në DVP Tiranë, nga data 24.03.1997 deri 04.11.1997 dhe nga 16.07.2002 deri 31.12.2003, në shumën 1.214.400 lekë.
- 5) Të ardhura nga puna si oficer policie, SKATET, strukturat antiterror në DPP, Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga 05.11.1997 deri 15.07.2002, në shumën 1.188.975 lekë.
- 6) Të ardhura nga puna si shef i policisë Kriminale në Komisarriatin e Policisë Krujë, nga 16.09.1996 deri 24.03.1997, në shumën 76.899 lekë.
- 7) Të ardhura nga puna si oficer policie, nga 01.08.1992 deri 16.09.1996, (nxjerrë me përfaqësi nga tabela e pagave dhe pagat për funksion të kohës), në shumën 320.262 lekë.
- 8) Shitje apartamenti 65.8 m², ndodhur në adresën Njësia nr.**, Rruga “Sitki Çiço”, Ndërtesa **, Hyrja **, Apartamenti **, Tiranë. Shitur me çmim 36.000 euro, pjesë takuese 1/2. Shuma e përfituar 18.000 euro.
- 9) Shitje autoveturë tip Volkswagen Jetta me targë AA****, subjektit Tirana International School, me Kontratë nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 20.08.2022, shuma 8.500 euro.

70. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin:

- a. Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Edmond Rizaj, për periudhën 16.09.1996 - 24.03.1997, në shumën neto 76.899 lekë.

- b. Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Edmond Rizaj, për periudhën 24.03.1997 - 04.11.1997 dhe 16.07.2002 - 31.12.2003, në shumën neto 1.214.400 lekë.
- c. Vërtetim nga Ministria e Brendshme, ku konfirmohen të ardhurat nga paga e Edmond Rizaj, për periudhën nëntor 1997 - Qershor 2001, në shumën neto 740.211 lekë.
- d. Vërtetim nga DPPSH, nr. *** prot, datë 13.04.2018, ku konfirmohen të ardhurat nga paga e Edmond Rizaj, për periudhën Korrik 2001 - Korrik 2002, në shumën neto 448.764 lekë.
- a. Vërtetim nga Akademia e Sigurisë, DPPSH, nr. *** Prot, datë 28.02.2023, ku konfirmohen të ardhurat nga paga e Edmond Rizaj, për periudhën 25.03.2004 - 27.06.2006 dhe 12.02.2018-27.01.2021, në shumën neto 4.830.253 lekë dhe shpërblime në shumën totale 536.811 lekë. (llogaritur të ardhurat vetëm për periudhën 25.03.2004 - 31.12.2005, në shumën 1.667.279 lekë)
- b. Vërtetim nga DPPSH, ku konfirmohen të ardhurat nga paga, shpërblime + leje e zakonshme, si dhe veshmbathje për Edmond Rizaj, për periudhën 27.01.2021 - 31.12.2022, në shumën neto 2.687.890 lekë.
- c. Kontratë Shitje Pasuri e Paluajtshme, nr. *** Rep., *** Kol., datë 03.04.2017 Apartament me nr. pasurie *** ZK ***, vol.**, fq.***, me sip. 65.8 m², në rrugën “Sitki Çiço”, Tiranë, në vlerën 36.000 Euro. Palë shitëse Edmond Rizaj dhe G. R.. *Bashkëlidhur Certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar në datë 07.02.2011.*
- d. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 18.10.2010, për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë për trashëgimlënësit A. R. dhe T. R., ku trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, rezultojnë Edmond Rizaj dhe G. R.. Autorizim nga Komiteti Ekzekutiv i KP Lagjes nr.*, Tiranë, datë 20.08.1984, lëshuar A. R., për strehimin e tij dhe familjes së tij në apartamentin 65.8 m², ndodhur në rrugën “Sitki Çiço”.
- e. Akt Shitje nga *** Auto, datë 14.08.2019, me administrator P. TH. Automjet Volkswagen Jetta, nr. shasie *****, në shumën 5.500 euro. Palë blerëse Edmond Rizaj.
- f. Kontratë Shitje automjeti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.08.2022. Palë shitëse Edmond Rizaj dhe palë blerëse Tirana International School. Automjet Volkswagen Jetta, në shumën 8.500 euro.

HETIMI ADMINISTRATIV

71. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar edhe të ardhurat e personave të lidhur me të në këtë rubrikë, konkretisht të ardhura e bashkëshortes nga paga + shpërblimet, për periudhën qershor 1999 -mars 2023 dhe të ardhurat e djalit Stiven nga paga dhe bursat. Këto të ardhura do të trajtohen tek deklaratimet e tyre respektive.

72. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga e subjektit, për periudhën Prill 2005 - Shkurt 2023, në shumën totale rreth 21.806.657 lekë (Llogaritur të ardhurat për periudhën Janar 2006 - Shkurt 2023, në shumën totale 21.150.683 lekë).

72.1 Konfirmohet në datë 10.04.2017, kreditimi i shumës 17.926 Euro, nga shitja e pasurisë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2017.

73. Të ardhurat nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit janë trajtuar më sipër.

74. Konfirmohen të ardhura nga Ministria e Brendshme dhe Kombet e Bashkuara për pjesëmarrjen në projekte të ndryshme gjatë vitit 2021 - 2022, në shumën 2.004 euro + 1.136\$.

75. Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga, shpërblimet dhe rimbursim telefoni për Edmond Rizaj, për muajin Dhjetor 2010 në shumën totale 183.224 lekë. (Nuk ka veprime të tjera në këtë llogari).

76. DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, konfirmon automjetin me targë AA****, në pronësinë e Edmond Rizaj.

76.1 *Praktika e blerjes dhe shitjes së automjetit, si dhe të adhuruat e përfituara nga shitja e automjetit Volkswagen Jetta janë trajtuar më sipër.*

77. ISSH, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon kontributet e derdhura për Edmond Rizaj, për periudhën Dhjetor 2012 - Mars 2023.

78. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. V-Prot., datë 16.5.2023 konfirmon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës. Bashkëlidhur:

78.1 Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni, nr. *** prot., datë 12.05.2023, ku konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës për Edmond Rizaj më datë 26.10.1987.

79. Në përfundim të hetimit administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

- ***Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, për periudhën shtator 1996 – mars 2023, konfirmohen në vlerën totale 25.481.461 lekë + 2.004 euro + 1.136 \$, e konvertuar rreth 25.834.000 lekë.***
- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfutuar me dëshmi trashëgimie, në shumën 9.000 euro.***
- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR, lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit tip Volkswagen Jetta, në shumën 8.500 euro.***

DETYRIME FINANCIARE

- 1) **Kreditim i apartamentit nga EKB** (Enti Kombëtar i Banesave) me vlerë 1.605.084 lekë, për t'u shlyer deri për 25 vite (nga viti 2002 deri në 2027) me këst mujor 5.200 lekë. Kontrata nr. 183 Rep, nr. 23 Kol, datë 8.2.2002. Detyrimi i mbetur 248.272 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon shlyerjet e kësteve të kredisë për Entin e Banesave.
- b. Vërtetim nr. *** prot., datë 14.6.2023, nga Enti Kombëtar i Banesave, ku konfirmohet se me z. Edmond Rizaj është lidhur kontratë shitje me kusht, nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 08.02.2002, për apartamentin e ndodhur në rrugën "Blloku Sizmik", seksioni **, ap.**, Tiranë. (dorëzuar nga subjekti i vlerësimit me inventarin nr.*** prot, datë 21.06.2023, pranë ILDKPKI-së)

80. Ky detyrim është trajtuar më sipër në Pasurinë nr.1 të subjektit, nga ku u konstatua se:

- ✓ **Kredia është marrë në vitin 2002 nga Enti Kombëtar i Banesave me afat shlyerje deri në vitin 2027.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Nga data 01.03.2002 deri në datë 01.03.2023, është paguar shuma 1.310.400 lekë.**
- ✓ **Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është 248.272 lekë.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

A. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- 1) Pagesa për OSHEE, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën 102.842 lekë.
- 2) Pagesa për Ujësjiellës - Kanalizime, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën 31.654 lekë.
- 3) Internet nga Vodafone (Ish - ABCom), për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën 19.200 lekë.
- 4) Telefona celular (5 numra gjithsej, dy unë, një bashkëshortja, një vajza dhe një nëna e bashkëshortes, 4 nga të cilët me ofertë 500 lekë në muaj për numër, një e përdor vetëm Roaming) për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën 29.980 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

81. Subjekti nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues për shpenzimet e sipërcituara në momentin e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë. Me inventarin nr.extra prot., datë 21.06.2023, subjekti paraqiti pranë ILDKPKI-së:

- a. Librezë me OSHEE në emër të Edmond Rizaj, nr. kontrate *****, me adresë rr. "Don Bosko".
- b. Librezë me UKT, në emër të Edmond Rizai, nr. kontrate *****, me adresë rr. "Don Bosko". Bashkëlidhur moduli i konsultimit të informacionit online, nga UKT.
- c. Kërkesë nga Edmond Rizaj, për pajtim në rrjetin Vodafone, e datës 16.01.2022, (printuar në datë 14.06.2023), për ofrimin e shërbimeve fikse internet + cable tv, me parapagesë me kohëzgjatje 24 muaj, në shumën 1.600 lekë muaj.
- d. Kërkesë për pajtim në rrjetin Vodafone Albania në emër të Edmond Rizai, me nr. ID G****S (është numri i subjektit) për 5 numra telefoni me tarifë mujore 500 lekë.
- e. Formular regjistrimi nga Vodafone Albania, për numrin *****, në emër të Edmond Rizaj.
- f. Formular aplikimi për faturë analitike në Vodafon Albania, datë 14.06.2023.
- g. Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen, në emër të Edmond Rizaj, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, ku konfirmohen pagesat për Vodafone për 5 numra telefoni çdo muaji. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 31.889 lekë.

82. FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 18.05.2023, konfirmon se në emër të Edmond Rizaj, figuron një kontrate furnizimi me nr. TR***** në instancën Tiranë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e FSHU.**
- ✓ **Konfirmohen pagesat e kryera për vitin 2022 (Janar - Dhjetor 2022) në shumën total rreth 104.141 lekë.**

83. Shoqëria Rajonale e Ujësjellës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

84. 14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. ****- *** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

85. Në lidhje me përgjigjen e ardhur nga UKT, ku konfirmohet se nuk ka asnjë kontratë me UKT në emër të tij dhe personave të lidhur, nëpërmjet inventarit nr.extra prot., datë 21.06.2023 të dorëzuar në ILDKPKI, ka sqaruar se ka kontratë me numër ***, zona **, por personeli ka gabuar duke shënuar emrin Edmond RIZAI (dhe jo Rizaj), e pavarësisht se prej vitesh iu ka kërkuar me shkrim ta korrigjojnë mbiemrin, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Gjithashtu subjekti ka bashkëlidhur librezën me UKT, në emër të Edmond Rizai, nr. kontrate ***, me adresë Rr. "Don Bosko", si dhe modulën e konsultimit të informacionit online, nga UKT.

86. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe pagesat e kryera për vitin 2022 (Janar - Dhjetor 2022), në shumën 31.647 lekë.

87. One Albania sh.a, me e-mail-in e datës 31.07.2023, konfirmon se Edmond Rizaj ka të regjistruar numrin +355*****2, për të cilin nuk ka pasur asnjë pagesë gjatë periudhës 01.01.2022- 31.12.2022.

88. Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr. *** prot., datë 13.07.2023, konfirmon se në emër të Edmond Rizaj, figurojnë të regjistruara 5 numra telefoni dhe konkretisht: +355*****1; +355*****8; +355*****3; +355*****1 dhe +355*****6 dhe shuma e paguar për vitin 2022 në total 61.639 lekë.

89. I pyetur mbi kontratat e lidhura me Vodafone, subjekti i vlerësimit ka dhënë sqarime me shkrim nëpërmjet inventarit nr.extra prot., datë 21.06.2023, ku ka deklaruar se:

89.1 Kontrata me Vodafone për internet, të datës 16.01.2022, është lidhur për 2 vite, për shumën 1.600 lekë në muaj (19.200 lekë në 2 vite).

89.2 Kontrata e numrit +355 *****, është lidhur me Vodafone në datë 05.06.2021 dhe përdoret nga ai personalisht vetëm për ofertat internet, kur shkon me shërbim jashtë shtetit. Sipas përlogaritjeve të tij, gjatë vitit 2022 janë shpenzuar 4.800 lekë për tre shërbime jashtë shtetit.

89.3 Kontrata e numrit +355 ***** (numri zyrtar i policisë) është lidhur me Vodafone për 500 lekë në muaj (6.000 në vit) por që paguhet nga Policia e Shtetit, ku përfshihen në paketë edhe 4 numra të tjerë. Katër numrat e tjerë të familjarëve, janë në ofertë që u është bërë të gjithë oficerëve të policisë që kanë një numër me Vodafone dhe paguajnë 500 lekë në muaj për çdo numër, pra 2.000 lekë në muaj (24.000 lekë në vit).

89.4 Subjekti ka sqaruar se të gjitha pagesat për numrat e telefonit kryhen nga ana e tij në llogarinë në Raiffeisen Bank, sipas marrëveshjes me këtë të fundit, në datën 20 të çdo muaji, përjashtuar numrin që përdor për Roaming, për të cilin bën ofertë sa herë është me shërbim jashtë shtetit.

89.5 Me e-mailin e datës 05.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI kthim-përgjigje nga Vodafone Albania, në lidhje me detyrimet mujore për periudhën Janar 2022 – Dhjetor 2023, nga ku konfirmohen pagesat e kryera për periudhën Janar 2022 - Dhjetor 2022, në shumën totale 31.889 lekë.

89.6 Gjithashtu, nga kontrolli dhe verifikimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit, krahas 5 numrave të deklaruar nga subjekti dhe të konfirmuar nga Vodafone Albania sh.a, në emër të subjektit të vlerësimit rezulton të jetë i regjistruar edhe një numër celular ONE Albania ++355*****.

89.7 Nga ana e Relatores, me e-mail-in e datës 22.11.2023 janë dërguar në adresën elektronike të subjektit pyetje, ku ndër të tjera i është kërkuar informacion mbi përdoruesin, periudhën e përdorimit dhe shpenzimet e kryera për këtë numër celular.

89.8 Në përgjigjen e protokolluar në AMP nr.*** prot., datë 01.12.2023 subjekti ka sqaruar se: “...është numri që ka (edhe aktualisht) në përdorim i biri, Stiven Rizaj. Nuk e kujtonte që numri është regjistruar në emrin e tij, pasi i biri e ka marrë celularin me fillimin e shkollës së mesme (ndoshta diku në vitin 2010). Nuk e ka deklaruar sepse ka menduar se i biri e kishte kaluar prej vitesh në emër të tij. Që nga data 17.02.2017 është transferuar në EAGLE (aktualisht ONE).

90. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e kompanive Vodafone Albania dhe ONE.

91. Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr.*** prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

92. Abissnet sh.a, me shkresën nr.*** prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

93. Digicom sh.a, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se subjekti dhe personat lidhur me të, nuk kanë marrë shërbim interneti për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

B. Shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

Subjekti ka deklaruar:

a. Shpenzime udhëtimi të Stiven Rizaj, Tiranë- Krakov, Poloni dhe anasjelltas, për periudhën Janar 2020 - Dhjetor 2022, në shumën 830 euro.

HETIMI ADMINISTRATIV

94. Subjekti i vlerësimit, në formularin e deklarimit të pasurisë, ka deklaruar vetëm shpenzime udhëtimi për djalin Stiven Rizaj për periudhën e përcaktuar. Nëpërmjet inventarit nr.extra prot. datë 21.6.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në ILDKPKI, ku ka sqaruar se:

94.1 Gjatë periudhës 01.01.2020 deri 31.12.2022, djali Stiven ka ardhur në Shqipëri 6 (gjashtë) herë, respektivisht çdo vit me nga dy raste, kryesisht për pushime të verës dhe festat e fundvitit.

94.2 Subjekti, gjatë periudhës 01.01.2020 deri 31.12.2022, ka dalë jashtë shtetit 9 (nëntë) raste, në 8 (tetë) prej të cilave për arsye pune dhe konkretisht, në Kosovë, Itali, Zvicër, Amerikën e Jugut, Çeki dhe Francë. Ndërsa është vetëm një dalje, kur me dy miq të tij të afërt, kanë shkuar për një vizitë të shkurtër dy - tre orë në Manastirin e Shën Naumit, që i përket kalimit të datës 16.08.2022.

94.3 Personat e tjerë të lidhur (bashkëshortja dhe vajza Ester), nuk kanë udhëtuar jashtë shtetit për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2022.

95. Për sa më sipër, subjekti i vlerësimit paraqiti nxjerrje nga sistemi TIMS për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, për të dhe personat e lidhur me të, konkretisht:

- a. Nxjerrje nga sistemi TIMS për Edmond Rizaj: Konfirmohen nga viti 2020 deri në datë 31.12.2022, gjithsej 9 hyrje-dalje.
- b. Nxjerrje nga sistemi TIMS për Stiven Rizaj: Konfirmohen nga viti 2020 deri në datë 31.12.2022, gjithsej 6 hyrje-dalje.
- c. Nxjerrje nga sistemi TIMS për Migena Rizaj: Nuk konfirmohen hyrje/dalje për periudhën 2019- 2022.
- d. Nxjerrje nga sistemi TIMS për Ester Rizaj: Nuk konfirmohen hyrje/dalje, për periudhën 2019-2022.

96. I pyetur në lidhje me rastet e daljeve të tij jashtë shtetit, gjatë periudhës 01.01.2020 - 06.03.2023, ku ka vënë në dispozicion urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim, nëpërmjet e-mailit të datës 23.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI sqarime me shkrim se:

96.1 Për një rast, kur kanë qenë në ndjekje të një operacioni ndërkombëtar, nuk ka urdhër, por ka shënuar dy linqe¹ që tregojnë prezencën e tij në përshëndetjet që ka bërë Ministri i Brendshmen i Kosovës, pas përmbylljes së operacionit.

- a. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar:
 - Urdhër nr. ***, datë 28.05.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim në Romë, Itali.
 - Urdhër nr. ***, datë 17.11.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim në Reggio Calabria, Itali.
 - Urdhër nr. ***, datë 10.05.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim në Lugano, Zvicër.
 - Urdhër nr. ***, datë 13.05.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim në Amerikën Latine, Kolumbi dhe Ekuador.
 - Urdhër nr. ***, datë 02.11.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dërgimin me shërbim në Pragë, Çeki. Të gjitha shpenzimet do të mbulohen nga pala çeke.
 - Shkresë nr. ***, datë 05.12.2022 "Ftesë për pjesëmarrje në "Vizitë Studimore" e Autoritetit Portual Durrës, për vizitën në Francë. Shpenzimet për akomodim përkthim dhe transport të brendshëm në Francë, do të mbulohen nga Autoriteti Portual Durrës, ndërsa shpenzimet për biletën e transportit ajror do të mbulohen nga DPPSH.

¹ <https://sinjali.com/ambasadori-italian-dhe-ekipet-operacionale-festoine-suksesine-kapjes-se-400-kg-kokaine-ne-lipian/>

<https://www.albinfo.ch/orlando-feston-suksesin-e-kapjes-se-400-kg-kokaine/>

96.2 Me e-mailin e datë 05.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- a. Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Edmond Rizaj, në monedhën euro, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
- b. Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen, në monedhën USD, në emër të Edmond Rizaj.

96.3 Ndërsa në kthim- përgjigjen e administruar në AMP me nr. 22/21, datë 01.12.2023, mbi pyetjen nëse këto të ardhura kanë shërbyer si shpërblim, apo janë konsideruar si dieta për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë pjesëmarrjes së tij në këto projekte, subjekti i vlerësimit dha sqarime se në të dy rastet, IPA dhe UN, organizatorët dhe financuesit e vizitave studimore në Itali dhe Colombi & Equador, kanë financuar të gjitha shpenzimet, udhëtim, akomodim dhe ushqim, për delegacionet. Sasitë monetare të kredituar në llogarinë e subjektit, janë dieta për të mbuluar shpenzimet e këtyre udhëtimeve, ku nuk përfshihen biletat e udhëtimit, pasi ato janë prenotuar dhe paguar nga vetë organizatorët.

96.4 Trupa e Vlerësimit kontrolloi dhe verifikoi kreditimet në llogaritë e subjektit të vlerësimit pranë Raiffeisen Bank, nga ku:

- ✓ Konfirmohen të ardhurat në monedhën euro nga pjesëmarrja në projektin IPA, në Maj 2022.
- ✓ Konfirmohen të ardhurat dhe monedhën USD nga pjesëmarrja në projektin e United Nations, në Qershor 2022.

97. Nga hetimi i kryer mbi shpenzimet e udhëtimit për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, Trupa e Vlerësimit konkludon se:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrie-daljeve, gjatë periudhës 2020 -2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, janë në total rreth 830 euro.

C. Shpenzime për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

1) **Stiven Rizaj**, ka qenë student në Universitetin AGH në Krakov, Poloni, prej vitit 2016. Vitin e parë ka përvetësuar gjuhën vendase. Diplomuar në Maj 2022. Shuma e shpenzuar 7.550 euro ose 32.500 Zloty (1 euro = 4.3 Zloty) kursi i këmbimit në atë periudhë.

Burimi i financimit: bursë e plotë (akomodim, ushqim, arsimim) nga Universiteti i AGH. Kredi për arsim nga RFZ Bank në vitin 2016, në vlerën 700.000 lekë, me afat shlyerje 5 vjet

(afërsisht 5.000 euro). Disbursuar 834.308 lekë, me 3.84 % interes vjetor (ose 19.19% në total). Shlyer në Maj 2021.

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Kontratë Kredie bankare, datë 25.05.2016, nga Raiffeisen Bank, me kredi marrës Edmond Rizaj dhe Migena Rizaj. Shuma 700.000 lekë, me qëllim përdorimi personal, afati 60 muaj dhe normë interesi 6.9% për tre vitet e para dhe mbas tre viteve tribor 1 vjeçar në ditën përkatëse + 6.5 %, e pandryshueshme deri në përfundim të Kontratës.
- b. Vërtetim nr. *** prot., datë 19.04.2018, nga Raiffeisen Bank.
- c. Dokumentacion në gjuhën polake, nga Akademia Gornicz-Hutnicza, datë 25.04.2018, mbi ndjekjen e programit të studimeve me kohë të plotë.

HETIMI ADMINISTRATIV

98. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon disbursim kredie në shumën 700.000 lekë, në datë 25.05.2016, në llogarinë e subjektit Edmond Rizaj, mbyllur në datë 25.05.2021.

99. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i vlerësimit dhe Raiffeisen Bank, (*Kontratë Kredie bankare, datë 25.05.2016, Vërtetim nga Raiffeisen Bank dhe CD me nxjerrjet bankare*), Trupa e Vlerësimit kreu verifikimet dhe llogaritit shpenzimet për pagesat e shlyerjes së kredisë (në monedhën lekë) sipas çdo viti dhe në total, të paraqitura më poshtë:

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Shpenzime Pagesë Kredie 25.05.2016 - 2021	72,841	165,934	165,934	185,251	175,580	73,255	838,795

100. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, si më poshtë vijon:

100.1 Vërtetim nga Universiteti AGH, datë 18.07.2016, nr. *** prot., ***-*** (në gjuhën polake + përkthimi në gjuhën shqipe), ku konfirmohet se Stiven Rizaj, u pranua për periudhën 01.10.2016 – 31.03.2020, në studimet e ciklit Bachelor me kohë të plotë, për të filluar vitin e parë të studimeve. Formimi ka filluar më datë 01.10.2016. Studenti kryen studimet me bursë të AGH.

100.2 Korrespondencë me Universitetin e Shkencës dhe Teknologjisë AGH, nr. RK***- ***, datë 18.07.2016, ku konfirmohet pranimi i aplikimit për programin e diplomimit në Universitetin e Shkencës dhe Teknologjisë AGH, për vitin e parë të vitit akademik 2016/2017. Kohëzgjatja e studimeve 7 semestra, si mbajtës i bursës së dhënë nga Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë.

100.3 Vërtetim nga Universiteti AGH, datë 25.04.2018, nr. ***-*** prot. (në gjuhën polake + përkthimi në gjuhën shqipe), ku vërtetohet se Stiven Rizaj, student i viti të parë bachelor i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Robotikës, në vitin akademik 2017/2018 është me bursë nga rektori i AGH dhe përfiton bursë në vlerën 650 ZL (zloty), në muaj. Bursa është e vlefshme për periudhën Tetor 2017 deri në qershor 2018.

101. Me inventarin nr.extra prot., datë 21.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI sqarime me shkrim, ku ka sqaruar se Stiven Rizaj, ka filluar studimet në AGH, më 01.10.2016 (njoftimi i Rektorit RK ***-***, datë 18.07.2016). Në vitin e parë universitar 2016/2017, fillimisht ka studiuar gjuhën polake dhe nga 01.10.2017 - 31.03.2021, për 7 semestra (3 vite e gjysmë kalendarike) ka qenë student me bursë të plotë (akomodim + ushqim). Është diplomuar më datë 30.05.2022.

- Gjatë vitit 2016, për periudhën 01.10.2016 deri 31.12.2016, ka përfituar 900 ZL në muaj x 3 muaj = 2.700 ZL;
- Gjatë vitit 2017, Janar - korrik ka përfituar 900 ZL në muaj x 7 muaj = 6.300 ZL, ndërsa periudha Tetor - Dhjetor ka përfituar 650 ZL në muaj x 3 muaj = 1.950 ZL, në total viti = 8.250 ZL;
- Gjatë vitit 2018, ka përfituar 650 ZL në muaj x 9 muaj = 5.850 ZL;
- Gjatë vitit 2019, ka përfituar 650 ZL në muaj x 9 muaj = 5.850 ZL;
- Gjatë vitit 2020, Janar - Qershor ka përfituar 650 ZL në muaj, x 6 = 3.900 ZL ndërsa periudha Tetor - Dhjetor ka përfituar 750 ZL në muaj x 3 muaj = 2.250 ZL, në total 6.150 ZL;
- Për vitin 2021, periudhën Janar - Mars, ka përfituar 750 ZL në muaj = 2.250 ZL.
- Shuma e të gjithë bursës në 4 vite e gjysmë është 31.050 Zloty.

102. Në lidhje me shpenzimet e djalit Stiven për qira apartamenti në Poloni dhe shpenzimet e jetesës (shpenzimet mujore), me e-mailin e datës 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se djali i tij Stiven Rizaj, ka qenë me bursë në Universitetin AGH në Krakov, Poloni nga Rektori i Universitetit dhe gjatë gjithë periudhës universitare, ka banuar në korpusin universitar të AGH (konvikt), pra nga 01.10.2016 deri në shtator 2022. Për shkak të çmimeve të larta të qirave, pas fillimit të luftës në Ukrainë, ku dyndjet migratore krijuan konfuzion në tregun e shtëpive të banimit, djali ka banuar në shtëpinë e një shoqes të tij, me adresë “Ulica Reymonta ** m. ***, Kod ***, Krakov, Poloni” dhe nga 01.04.2023, që i përket një periudhe pas dorëzimit të deklaratës, ka marrë një banesë me qira.

Subjekti ka bashkëlidhur kopje të Kontratës së qirasë (në gjuhën polake), datë 30.03.2023.

103. Subjekti i vlerësimit ka përcjellë dokumentacion dhe sqarime shtesë drejtuar IDKPKI-së dhe Relatores së Trupës së Vlerësimit në lidhje me nxjerrjet e llogarive bankare të djalit në Poloni, për të vërtetuar pagesat e kryera për akomodimin dhe konviktin.

104. Për sa më sipër, Trupa e Vlerësimit verifikoi dhe analizoi shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, konkretisht:

104.1 Nga korrespondenca me Universitetin e Shkencës dhe Teknologjisë AGH, datë 18.07.2016 (në gjuhën angleze), konfirmohet pranimi i aplikimit për programin e diplomimit në Universitetin e Shkencës dhe Teknologjisë AGH, për vitin e parë të vitit akademik 2016/2017. Kohëzgjatja e studimeve 7 semestra, si mbajtës i bursës së dhënë nga Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë AGH.

104.2 Nga nxjerrja e llogarisë në Bankën Pekao, në emër të Stiven Rizaj, për periudhën 10.11.2016 – 10.02.2021, konfirmohet se është bërë kreditimi i bursës së akredituar nga AGH dhe shuma totale e përfituar 30.950 PNL (zloty) (**konvertuar afërsisht 7.200 euro**).

104.3 Nga nxjerrja e llogarisë në Pekao Bank në emër të Stiven Rizaj, konfirmohen pagesat e kryera për akomodimin për periudhën 12.12.2016 - 21.08.2021, në shumën totale 15.279 PNL (zloty).

104.4 Nga nxjerrja e llogarisë në Santander Bank, konfirmohen pagesat e kryera nga Stiven Rizaj për konviktin për periudhën 14.07.2021 - 11.09.2022, në shumën totale 6.013 PNL (zloty).

105. Në tabelën më poshtë janë llogaritur nga Trupa e Vlerësimit të ardhurat nga bursa e djalit Stiven Rizaj, të konvertuara në monedhën Lekë sipas viteve përkatëse, ku në total ka rezultuar afërsisht 875.867 lekë.

(në lekë)	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Të ardhura nga bursa 1.10.2016 - 31.03.2021	72,046	258,338	169,424	166,238	169,223	40,598	875,867

106. I pyetur në lidhje me studimin e vajzës **Ester Rizaj**, fillimin, llojin dhe emrin e institucionit arsimor, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim me inventarin nr. *** prot. datë 21.06.2023 se, vajza ka kryer shkollën 9-vjeçare Qazim Turdiu (shkollë publike) nga viti 2010 deri në vitin 2019. Në vitin 2019 ka filluar gjimnazin në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Qemal Stafa (shkollë publike) dhe e ka përfunduar në vitin 2022. Vitin akademik 2022 - 2023 nuk është regjistruar në asnjë universitet. Ka dorëzuar:

- *Dëftesë e arsimit bazë nr.***, për vitin shkollor 2018- 2019, klasa e nëntë për E. Rizaj, nga shkolla 9 vjeçare "Qazim Turdiu" Tiranë.*
- *Certifikatë e Maturës Shtetërore nr. regjistri i veçantë ***, për E. Rizaj, lëshuar nga Gjimnazi "Qemal Stafa " Tiranë, datë 05.07.2022.*

107. Nga kryerja e hetimit administrativ, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërisë financiare, Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- ✓ Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e djalit Stiven Rizaj gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë rezultojnë në total rreth 700.000 lekë nga kredia e marrë nga prindërit + 30.950 Zloty (7.200 euro) nga bursa e akorduar nga universiteti AGH në Krakov, Poloni.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, lidhur me kredinë e marrë në vitin 2016 për fillimin e studimeve të djalit në Poloni dhe shlyerjen e saj deri në vitin 2021.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe nxjerrjen e llogarisë nga Pekao Bank, lidhur me kreditimin e bursës për Stiven Rizaj nga AGH, Poloni.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe nxjerrjet e llogarive nga bankat Pekao Bank dhe Santander Bank, mbi pagesat e kryera për akomodim dhe konviktin nga Stiven Rizaj.

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR, MIGENA RIZAJ (BASHKËSHORTJA E SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT)

DEKLARIMI I PASURIVE

- 1) **Apartament me sipërfaqe 72.55 m²**, ndodhur në adresën: Njësia **, Rruga “Androkli Kostallari”, ndërtesa **, hyrja **, apartamenti **, Tiranë. Prona me nr. ***, ZK ***.
- Burimi i krijimit:** Dhuruar nga F. S. (nëna e personit të lidhur me subjektin). Rivlerësuar me 5.570.950 lekë. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.06.2017.
- Vlera:** 5.570.950 lekë, në rivlerësim para veprimeve kontraktuese të dhurimit.
- Pjesa në %:** 100%

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë Dhurimi nr. *** Rep., nr. *** Kol., datë 17.6.2017. Apartament me nr. pasurie ***, ZK.***, vol.**, fq.**, me sipërfaqe 72.55 m², ndodhur në Don Bosko, Tiranë. Dhurues F.S. dhe palë pranuese e dhurimit Migena Rizaj.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, për apartament me sipërfaqe 72.55 m², nr. pasurie ***, në emër të Migena Rizaj, lëshuar në datë 29.06.2017.

HETIMI ADMINISTRATIV

108. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, Trupa e Vlerësimit u bazua në informacionin e përfutur nga raporti i ILDKPKI-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet bankare dhe jo-bankare, si dhe nga korrespondenca/sqarimet me subjektin e vlerësimit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

108.1. ASHK Tiranë, DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Jug, DV Tirana Rurale 1, DV Kamëz Vorë, DV Tiranë Rurale 2, me shkresat nr. *** prot., datë 12.06.2023, datë 16.06.2023, datë 26.06.2023 dhe datë 29.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Edmond Rizaj dhe personave të lidhur.

108.2. ASHK, DV Tiranë Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 26.06.2023, konfirmon se Migena Rizaj ka të regjistruar apartamentin me sipërfaqe 72.55 m², ZK ***, vol.**, fq.**.

108.3. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga ASHK, DV Tiranë Veri, konkretisht:

- a. Kartelën e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie *** ZK ***, vol.**, fq.**, ku rezulton apartament me sipërfaqe 72.55 m², në emër të Migena Rizaj, regjistruar në datë 29.06.2017 me Kontratë Dhurimi
- b. Formularin e rivlerësimit të pasurisë, ku konfirmohet se vlera e rivlerësuar e apartamentit është 5.570.950 lekë.
- c. Kontratën e Dhurimi nr.*** rep., nr. *** kol., datë 17.06.2017, të apartamentit me nr. pasurie ***, ZK.***, vol.**, fq.**, me sipërfaqe 72.55 m², ndodhur në Don Bosko, Tiranë, nga ku konfirmohet se F. S. është palë dhuruese dhe palë pranuese e dhurimit është Migena Rizaj.
- d. Certifikatën për vërtetim pronësie në emër të F.S., për apartament me sip. 72.55 m², nr. pasurie ***, vol.**, fq.**, lëshuar në datë 25.05.2017. *Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme.*

109. ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 20.06.2023, konfirmon se F. S., trajtohet me pension pleqërie, prej datës 13.06.2007 deri në datë 06.03.2023. Bashkëlidhur:

- *Librezë pune për F. M., ku konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës prej datës 05.05.1970 deri në 01.05.1997.*
- *Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, ku konfirmohen të ardhurat për periudhën Janar 1994- Prill 1997, në shumën totale 42.620 lekë.*

110. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, ka bashkëlidhur:

- *Vërtetim për vjetërsi në punë, për efekt pensioni për F. M., ku konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 5.5.1973 deri në datë 15.8.1975.*

111. Në lidhje me kohën e përfitimit të këtij aseti nga nëna e bashkëshortes së subjektit të vlerësimit, si dhe burimin e krijimit të saj, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në ILDKPKI, ku ka deklaruar se në datën 2.6.2000, kur ka lidhur “Kontratën e Përkohshme për apartament banimi” me Entin Kombëtar të Banesave, për shitjen me këste të apartamentit me adresë Rr. “Blloku Sizmik” (i njëjti ku banon sot, por kanë ndryshuar disa herë emrat e rrugëve dhe numrat) dhe pallati ishte në ndërtim e sipër, prindërit e bashkëshortes, që ishin në gjendje të mirë financiare, vendosën për të blerë një apartament pranë tyre dhe kështu në vitin 2001, me kontratë

shitje nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 23.07.2001, i blenë shtetasit A. Ç., apartamentin me adresë Rruga “Blloku Sizmik”; Pallati **, Shkalla **, Apartamenti **, Tiranë.

Subjekti ka theksuar faktin se pavarësisht aktit të dhurimit, në këtë banesë vijon të banojë nëna e bashkëshortes F.S..

112. Në mbështetje të sqarimeve të dhëna, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin shtesë justifikues².

113. Gjithashtu, për sa i përket mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie, me e-mailin e datës 23.06.2023 dërguar ILDKPKI-së, subjekti ka dhënë shpjegime shtesë lidhur me aktivitetet private të vjehrrit të tij të ndjerë Gj. (G.) S..

- Në mënyrë të përmbledhur, në vitin 1992, G.S. ka privatizuar nga Ndërmarrja e Bonifikimit të Tiranës, një impiant inertesh në Mullet, Tiranë. Firma e themeluar quhej “Erzeni” shpk dhe ai ishte bashkë-ortak me nga 50% me një person tjetër.
- Në vitin 1993 ose 1994, ata bënë ortakëri me tre biznesmenë italianë, të cilët investuan kapitale të mëdha në modernizimin e makinerive, pajisjeve dhe flotës së mjeteve, duke ndryshuar emrin e firmës në "IT-AL-ERZENI" Sh.P.K. (bashkëlidhur një dokument për ndarjen e aksioneve në 27.01.1995, ku vërehet G. S. ishte ortaku i dytë në radhë, për sa i përket sasisë së aksioneve). Në vitin 1996, vjehri i ti G. S., u shiti ortakëve të tij italianë aksionet e tij dhe shkëputi marrëdhëniet me këtë firmë. Për të kuptuar fuqinë financiare të tyre, subjekti sjell në vëmendje se dy nga ortakët e vjehrrit të tij, italianët A. D. S. dhe V. M. në atë periudhë ishin, i pari President dhe i dyti Zëvendës President të Klubit të Sportit Partizani.
- Po ashtu, në vitin 1994, vjehri i tij krijoi një firmë tjetër të quajtur "Sejko GTS" sh.p.k., edhe kjo operonte në të gjitha sferat e fushës së ndërtimit. Në vitin 1998, duke qenë se kishte gjendje të mirë financiare preferoi të dilte në pension dhe të ndërpriste aktivitetet e biznesit. *Subjekti ka vënë në dispozicion vendimin e likuidimit të shoqërisë.*
- Vjehri i tij ka ndërruar jetë në vitin 2009 (*bashkëlidhur vendimi Akti dhe Vendimi i Gjykatës Tiranë për çeljen e trashëgimisë ligjore*), e në këto kushte, kur edhe e shoqja nuk ka patur dijeni për veprimtarinë e tij në biznes, nuk ka informacion më të zgjeruar se kaq.
- Thekson se vjehrra e tij F. S., akoma gëzon të ardhura financiare të trashëguara nga i shoqi, që deri vonë i ka patur në Bankën e Shqipërisë në formë bono thesari, por që i ka tërhequr të gjitha në kohën e pandemisë së Covid-19.

² Certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, për pasurinë apartament me sip.72.55 m² me nr. pasurie ***, vol.***, fq.***, ZK ***, në emër të Migena Rizaj, lëshuar në dt. 29.06.2017. Bashkëlidhur Kartela e Pasurisë së Paluajtshme.

Certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, për pasurinë apartament me nr. pasurie ***, vol.***, fq.***, ZK ***, në emër të Fatbardha Sejko, lëshuar në dt. 25.05.2017.

Vërtetim pronësie nga dokumentet Hipotekore, ku vërtetohet regjistrimi në nr. hipotekor ***, ZK ***, dt. 23.07.2001, i pasurisë apartament me sip. 72.55 m², në adresën “Blloku Sizmik” pallati **, shkalla e parë, apartamenti **, në emër të F. S.. Origjina e regjistrimit nga numri ***, dt. 19.06.2001.

Kontratë Shitje (apartament 2+1) nr.*** rep., nr.*** kol., dt. 16.07.2001, me palë shitëse A. Ç., H. Ç. dhe K. Ç. dhe palë blerëse F. S.. Apartament me sip.72.55 m², ZK ***, nr. pasurie ***, regjistruar në numrin hipotekor ***, dt. 19.06.2001, në vlerën 3.600.000 lekë. Pagesa është bërë e plotë dhe e menjëhershme jashtë zyres noteriale.

114. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar:

- b. Vendim për ndryshime në regjistrin tregtar, nr. *** Vendimi, datë 27.01.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ku është vendosur pranimi i ortakëve të rinj, ndryshimi i kuotave të tyre dhe zmadhimi i kapitalit të shoqërisë nga 100.000 lekë në 30.000.000 lekë, ku G. S. ka zotëruar 10% të kapitalit themeltar =3.000.000 lekë.
- c. Artikullin e printuar nga gazeta Panorama Sport në datë 14.03.2020.
- d. Vendim nr. ***, datë 01.04.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për likuidimin e shoqërisë “Sejko GTS” shpk të ortakut të vetëm të saj G. S..
- e. Vendim nr.***, datë 31.05.2011, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin G.(Gj.) S., ku konfirmohet se Gj. S. ka ndërruar jetë në datë 06.04.2009 dhe si trashëgimtarë ligjor të radhës së parë të tij janë F. S./bashkëshortja, Migena Rizaj (Sejko)/vajza dhe J. S./djali.

115. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe korrespondencën me subjektin, në përfundim të hetimit rezulton se:

- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin e përdorur nga prindërit e bashkëshortes për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

2) Kontratë Dhurimi nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 28.07.2017, dhuruar vëllait J. S., ½ e apartamentit me sip.65.27 m², ndodhur në adresën: Njësia nr.***, Rruga “Qemal Stafa”, Ndërtesa ***, hyrja **, Ap.**, Tiranë. Prona me nr. ****, ZK****.

Burimi i krijimit: Apartament i fituar nga privatizimi. Pjesa 1/2 dhuruar nga F. S. (nëna e personit të lidhur me subjektin).

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Kontratë Dhurimi nr. *** Rep, nr. *** Kol., datë 28.07.2017, për 1/2 pjesë takuese në apartamentin me sip. 65.27 m², nr. pasurie *** ZK****, vol.***, fq.***, ndodhur në Rr. “Qemal Stafa”.

HETIMI ADMINISTRATIV

116. Trupa e vlerësimi mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, përgjigjet e institucioneve ligjzbatuese (ASHK, ISSH, etj.), duke mbajtur në konsideratë raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe sqarimet/shpjegimet me shkrim të subjektit gjatë korrespondencës së mbajtur.

116.1 ASHK me shkresën nr. *** prot., datë 12.06.2023, nuk konfirmon pasurinë në emër të subjektit Migena Rizaj.

116.2 ISSH, me shkresën n. *** prot., datë 20.06.2023, ka bashkëlidhur:

- *Librezë pune për F. M., ku konfirmohet fillimi i marrëdhënieve të punës, prej datës 05.05.1970 deri në 01.05.1997.*
- *Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, ku konfirmohen të ardhurat për periudhën Janar 1994 - Prill 1997, në shumën totale 42.620 lekë.*

116.3 ISSH, drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. *** prot., datë 22.06.2023, ka bashkëlidhur:

- *Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni për F. M., ku konfirmohen marrëdhëniet e punës për periudhën 05.05.1973 deri në datë 15.08.1975.*

117. Në lidhje me burimin e krijimit, personi i lidhur Migena Rizaj, ka deklaruar se është apartamenti i fituar nga privatizimi, pjesa ½ dhuruar nga F. S.. I pyetur mbi këtë aset, subjekti i vlerësimit në sqarimet e tij me shkrim, ka deklaruar se apartamenti për të cilin bëhet fjalë, është banesa e përfitur nga privatizimi nga prindërit e bashkëshortes Migena Rizaj.

117.1 Me Kontratë Shitblerje nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 19.12.2000, Gj. S., babai i bashkëshortes i shet pjesën takuese (½ e pronës) të birit, J. S., e në këto kushte, ky apartament bëhet me dy bashkëpronarë me nga ½ e pronës: kunatin J. S. dhe vjehrrën F. S., bashkëpronare që në privatizim.

117.2 Me Kontratë Dhurimi nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 27.12.2011, F. S., nëna e bashkëshortes, i dhuron pjesën e saj takuese (½ e apartamentit) bashkëshortes Migena Rizaj (bashkëlidhur kontrata dhurimit), e në këto kushte apartamenti, objekt shqyrtimi, bëhet pronë e J. S. dhe M. S., me 4 pjesë secili.

117.3 Me Kontratë Dhurimi nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 28.07.2017, bashkëshortja Migena Rizaj, i dhuron të vëllait J. S., pjesën e saj takuese prej ½ (bashkëlidhur kontrata e dhurimit) dhe i gjithë apartamenti bëhet 100% i tij.

117.4 Sipas deklaramit të subjektit, të gjitha këto lëvizje janë kryer nga nëna e bashkëshortes F. S., në mënyrë që pasi të ndërrojë jetë, të mos i lërë me konflikt për pronat fëmijët e saj, por secili të trashëgojë një nga apartamentet, nga ato të fituar nga ajo dhe bashkëshorti i saj gjatë jetës.

118. Gjatë kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar, konkretisht Kontratë Dhurimi nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., datë 28.07.2017, për ½ pjesë takuese në apartamentin me sip.65.27 m², nr. pasurie *** **ZK **40**, vol.***, fq.**, u konstatua se kishte një mospërputhje me paragrafin e Objektivit të Kontratës ku thuhet se: “Objekti i kontratës është kalimi i pjesës takuese të përbërë prej 1/2 të znj. Migena Rizaj në pasurinë nr. ***, **ZK **30** vol.**, fq.**. me sip. totale prej 75.55 m², apartament ndodhur në Rr. “Don Bosko”, nga dhuruesi Migena Rizaj tek pranuesi Z. J. S. pa shpërblim”.

118.1 Në lidhje me problemin e konstatuar mbi pjesën e dhuruar nga bashkëshortja, pra nëse është ½ e apartamentit me nr. pasurie **** në Rr. Qemal Stafa apo ½ e apartamentit me nr. pasurie **** në Rr. Don Bosko, subjekti ka sqaruar se, duket që është një gabim material, pasi bashkëlidhur janë dy Certifikatat e Pronësisë, për të dy apartamentet, që vërtetojnë se ai gabim material nuk është marrë në konsideratë nga Hipoteka gjatë procesit të regjistrimit të pasurive në fjalë.

118.2 Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues³.

119. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Apartamenti me sip. 65.27 m² në Rr. “Qemal Stafa”, Tiranë, ishte përfituar nga prindërit e bashkëshortes së subjektit në vitin 1993, nga privatizimi i banesave. Rezulton se në vitin 2000 babai i bashkëshortes i shiti djalit të tij pjesën takuese ½ e këtij apartamenti, kurse në vitin 2011 nëna e saj i dhuron pjesën e saj takuese ½ vajzës Migena Rizaj, e cila në vitin 2017, ia kalon me kontratë dhurimi vëllait J. S., duke u bërë ai pronar 100% i këtij apartamenti.

✓ **Konfirmohet deklarinimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- 1) Të ardhura nga paga në AKBPM (Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësorë) për periudhën Qershor 1999 - Mars 2023 (nga viti 2005, kliente e Raiffeisen Bank), në shumën 11.243.500 lekë.
- 2) Të ardhura nga shpërblimet në AKBPM për periudhën Qershor 1999 - Mars 2023 (nga viti 2005, kliente e Raiffeisen Bank), në shumën 1.813.524 lekë.
- 3) Llogari bankare në Raiffeisen Bank në datë 31.12.2022, në shumën 944 lekë.

³ Kontratë për privatizim banese dt. 13.12.1993, në emër të G. S., për banesën nr.***, Rr. Qemal Stafa, pallati ***, shk.***, kt. **, e përbërë nga 2 dhoma dhe 1 kuzhinë.

Kontratë shitblerje nr. *** Rep. dhe nr. *** Kol., dt. 23.11.2000. Palë shitëse G.S. dhe palë blerëse J. S., 1/2 pjesë e apartamentit me nr. ***, shk.***, pallati ***, në Rr. “Qemal Stafa”, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, dt. 24.03.1994, me sip.65.27 m², në shumën 500.000 lekë.

Kontratë Dhurimi nr. *** Rep., nr. *** Kol., dt. 27.12.2011. Dhurues F. S. dhe pranuese e dhurimit, Migena Rizaj, pjesë e apartamentit me sip.65.27 m², nr. pasurie ****, vol.***, fq.** ZK ***, me adresë Rr. “Qemal Stafa”, pallati ***, shk. **, ap. **, Tiranë.

Certifikatë për Vërtetim pronësie nr. ****, apartament me sip. 65.27 m², nr.pasurie ****, vol.***, fq. **, ZK ***, me adresë Rr. “Qemal Stafa”, pallati ***, shk. **, ap. **, Tiranë, në emër të J. S. dhe Migena Rizaj, lëshuar në dt. 13.01.2012. *Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme.*

Kontratë Dhurimi nr. *** Rep, nr. *** Kol, dt. 28.07.2017, për 1/2 pjesë takuese në apartamentin me sip, 65.27 m², nr. pasurie ***, ZK ***, vol.***, fq.***, ndodhur në Rr. “Qemal Stafa”, Dhurues Migena Rizaj me pjesë takuese ½ të pronësisë së apartamentit dhe pranues dhurimi J.S. (vëllai i saj).

Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, apartament me sip.65.27 m², nr.pasurie ****, vol. **, fq.***, ZK ****, me adresë Rr. “Qemal Stafa”, godina ***, hyrja **, ap.***, në emër të J. S., lëshuar në dt. 06.09.2017. *Bashkëlidhur Kartela e pasurisë së paluajtshme.*

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Vërtetim për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga ISSH, për të ardhurat nga paga për Migena Rizaj, për periudhën Qershor 1999- Dhjetor 2022.
- b. Vërtetim nga AKBPM, nr. *** prot. dhe datë 26.4.2018, për të ardhurat neto nga shpërblimet për Migena Rizaj.

HETIMI ADMINISTRATIV

120. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin justifikues bashkëlidhur deklaratës, nga ku rezultoi se:

- a. Të ardhurat nga paga për Migena Rizaj janë:
 - Për periudhën Qershor 1999 - Prill 2005, në shumën totale 1.028.681 Lekë.
 - Për periudhën Qershor 1999 - Dhjetor 2022, në shumën totale neto rreth 11.106.542 lekë.
- b. Të ardhurat neto nga shpërblimet për Migena Rizaj janë:
 - Për periudhën 1999 - Prill 2005, në shumën totale rreth 985.666 lekë.
 - Për periudhën 1999 - 2011, në shumën totale neto 1.813.524 lekë.

121. Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot. datë 8.5.2023, konfirmon në emër të Migena Rizaj:

- Të ardhura nga paga për periudhën Prill 2005 - Shkurt 2023, në shumën totale rreth 11.246.695 lekë.
- Balancë në llogari page në datë 06.03.2023, shumën 27.776 lekë.
- Overdraft me balancë -70.000 lekë.

122. Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, vjen si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 31.12.2022, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 06.03.2023.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, lidhur me të ardhurat e Migena Rizaj nga pagat dhe shpërblimet.**
- ✓ **Të ardhura e bashkëshortes nga paga dhe shpërblimet, për periudhën Qershor 1999 - Mars 2023, janë rreth 13.261.000 lekë.**

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR - STIVEN RIZAJ

DEKLARIMI I PASURIVE

1) **Automjet**, me targë KR****, e llojit Volkswagen Golf, vit prodhimi 2003, blerë në datë 05.05.2021.

Çmimi i blerjes: 4.000 Zloty (monedha dhe pagat polake) 820.5 euro (kursi i këmbimit euro=4.8 zloty).

Burimi i krijimit: Nga kursimet e marra nga puna.

HETIMI ADMINISTRATIV

123. Personi i lidhur me subjektin e vlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues në momentin e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, por sipas inventarit nr.extra prot. datë 21.06.2023 në ILDKPKI, subjekti ka dorëzuar:

- a. Kontratë Shitje Automjet Volkswagen Golf, datë 05.05.2021, ku konfirmohet pala blerëse Stiven Rizaj dhe palë shitëse D. M., si dhe vlera 4.000 Zloty sipas përcaktimit në pikën 3 të kontratës.

124. Për të vërtetuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, u morën në shqyrtim të ardhurat nga pagat sipas deklaramit të personit të lidhur dhe dokumentacionit justifikues të dorëzuar, konkretisht:

- a. Nxjerrje llogarie nga ING Bank, në emër të Stiven Rizaj (në gjuhën polake), ku konfirmohet gjendja llogarisë në datë 30.01.2021 në shumën 3.000 euro dhe në datë 31.01.2021, shuma 0 euro.
- b. Nxjerrje llogarie nga Santander Bank, ku konfirmohet kreditimi i shumës 1.500 euro nga Stiven Rizaj, në datë 24.06.2021 dhe 05.08.2021.

124.1 Sipas kursit mesatar të këmbimit Maj 2021, vlera e blerjes së automjetit është: 4.000 zł * 0.205⁴ €/zł = 820 euro.

124.2 Sipas kursit të këmbimit të datës 05.05.2021 marrë nga arkiva e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë rezulton se vlera e automjetit të blerë është: 123.11 lek/euro * 820 euro = 100.950 lekë.

125. Trupa e Vlerësimit kreu llogaritjet mbi mundësinë për kursim nga të ardhurat nga paga të Stiven Rizaj, duke mbajtur në konsideratë shpenzimet jetike mujore dhe shpenzimet për akomodim (sipas sqarimeve të subjektit të vlerësimit), nga ku rezulton se:

- ✓ **Ka patur të ardhura të ligjshme për të krijuar pasurinë e luajtshme me vlerë 820 euro (konvertuar rreth 100.950 lekë).**
- ✓ **Automjeti Volkswagen Golf është përfituar nga djali i subjektit me kontratë blerje të vitit 2021.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

⁴ Referuar kursit të këmbimit dt. 05.05.2021 [Polish Zloty rates for 05/05/2021](#)

- 1) Të ardhura nga bursa, për periudhën 2007 - 2010, akorduar nga Bashkia Tiranë, si stimul për nxënës i shkëlqyer, Janar 2007 - Maj 2010 tek Credins Bank, shuma 81.000 lekë. Lënë depozita deri në datë 20.05.2014, tërhequr plotësisht.
- 2) Të ardhura nga puna në kompaninë Lloto Sport Sha., për periudhën 07.02.2015 – 31.03.2016, në shumën 360.280 lekë. Veprimet tek BKT.
- 3) Të ardhura nga bursa e dhënë Universiteti AGH, rreth 32.500 Zloty (1 euro =4.3 Zloty: kursi i këmbimit në atë periudhë). Konvertuar rreth 7.550 Euro. Nga data 01.10.2016 deri në datë 31.03.2021. **Adresa:** Shteti Poloni, Rruga “Ulica Reymonta” ** nr. ***, Kod ***, Krakov, Poloni.
- 4) Të ardhura nga pagat nga data 01.05.2021 në datë 31.12.2021, shuma 3.220 euro. Në total 15.456 Zloty (euro=4.8 Zloty) ose 3.171 Euro. Vendi i Punës:
Maj- Gusht 2021, në Proster Spolka, Poloni.
Nëntor - Dhjetor 2021, në Capgemini Polska Sp. Z.O.O. Krakov, Poloni.
- 5) Të ardhura nga pagat, nga data 01.01.2022 - në datë 31.12.2022, në total 57.000 Zloty (1 euro= 4.8 Zloty) ose 11.875 euro. Vendi i punës:
Janar- Prill 2022, në Capgemini Polska SP. Z.O.O., Krakov, Poloni, Kodi Postar *-***.
Maj- Dhjetor 2022, në Sr. Anls, Bussiness Mgmt GSA- Europe, Krakov, Kodi Postar *-***.

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank për të ardhurat e Stiven Rizaj për periudhën Janar 2007 - Korrik 2009.
- b. Nxjerrje llogarie nga BKT, në emër të Stiven Rizaj.
- c. Dokumentacion në gjuhën polake nga Akademia Gornicz-Hutnicza, datë 25.04.2018, mbi ndjekjen e programit të studimeve me kohë të plotë.

HETIMI ADMISTRATIV

126. BKT me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga e Stiven Rizaj, për periudhën Shkurt 2015 - Mars 2016, në shumën totale 360.000 lekë.

127. Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, konfirmon të ardhurat nga bursa e Stiven Rizaj, për periudhën 2007 - 2010, në shumën totale 81.000 lekë. Gjithashtu, konfirmohet hapje depozite në datë 09.08.2008, në shumën 20.000 lekë, deri në datë 20.05.2014, ku është tërhequr shuma 155.260 leke.

128. Shuma e të gjithë bursës së akredituar në emër të Stiven Rizaj nga Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë AGH **është trajtuar më sipër** në rubrikën “shpenzimet e deklarueshme” të subjektit të vlerësimit, ku janë marrë në shqyrtim sqarimet shtesë me shkrim dhe dokumentacioni i përcjellë gjatë gjithë fazës së procesit të vlerësimit.

129. Nëpërmjet korrespondencës me ILDKPK-në dhe Relatoren e Trupës së Vlerësimit, subjekti ka dhënë sqarime dhe dokumentacion shtesë për sa i përket të ardhurave nga pagat, lëvizjet bankare dhe gjendjet e llogarive të djalit Stiven Rizaj në Poloni dhe konkretisht:

129.1 Nxjerrje llogarie nga Santander Bank datë 16.06.2023, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën Qershor - Korrik 2021 dhe Nëntor - Dhjetor 2021, në shumën 11.842 PNL (zloty), konvertuar në monedhën Euro sipas kursit mesatar të këmbimit⁵: $0.2191 \text{ Euro/PNL} * 11.842 \text{ PNL} = 2.595 \text{ euro}$.

129.2 Nxjerrje llogarie nga Santander Bank, datë 23.02.2023, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Stiven Rizaj, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën totale rreth 57.000 PNL (zloty), konvertuar në monedhën Euro sipas kursit mesatar të këmbimit $0.2135 \text{ EUR/PNL} * 57.000 \text{ PNL} = 12.170 \text{ euro}$.

129.3 Nxjerrje llogarie nga Santander Bank, datë 16.6.2023, ku konfirmohen të ardhurat nga paga për Stiven Rizaj, për periudhën Janar - Shkurt 2023, në shumën 11.137 PNL (zloty), konvertuar në monedhën euro sipas kursit mesatar të kohës $0.2139 \text{ Euro/PNL} * 11.137 \text{ PNL} = 2.382 \text{ Euro}$.

129.4 Në lidhje me shpenzimet e djalit për akomodim dhe shpenzime për konsum dhe jetesë, subjekti ka deklaruar se djali i tij Stiven Rizaj, ka banuar në korpusin universitar të AGH (konvikt), nga 01.10.2016 deri në shtator 2022 dhe pagesat për qira apartamenti kanë filluar nga data 01.04.2023. *Subjekti ka theksuar se djali i tij, deri në datën 31.03.2021 është trajtuar me bursë dhe në datë 01.05.2021 ka filluar punë.*

129.5 Të ardhurat nga paga e tij, të kredituara në Santander Bank nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim, kanë qenë rreth 78,739 Zloty. Në të nuk përfshihet vetëm paga e parë e muajit Maj 2021, që i ka kaluar në Pakao Bank, në vlerën rreth 2.530 (dymijë e pesëqind e tridhjetë) Zloty. *Pra, shuma totale e të ardhurave nga pagat ka qenë rreth 81.270 Zloty.*

129.6 Subjekti ka dorëzuar nxjerrjet e llogarive nga Santander Bank për të vërtetuar shumën e përgjithshme të të ardhurave nga paga dhe gjendjet e llogarive.

130. Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet e djalit S. R. paraqiten si më poshtë:

- Të ardhura nga paga dhe bursa në Shqipëri (2007- 2016), rezultojnë 440.000 lekë.
- Të ardhura nga bursa në Poloni (2016 – 2021), rezultojnë në shumën totale rreth 30.950 PNL (zloty), konvertuar rreth 7.200 euro ose 827.000 lekë.
- Të ardhura nga paga nga punësimi në Poloni (Qershor 2021 - Shkurt 2023), rezultojnë në shumën rreth 80.000 PNL (zloty), konvertuar rreth 18.600 euro ose 2.136.000 lekë.
- Shpenzime për konsum dhe jetesë (Maj 2021 – Shkurt 2023), rezultojnë në shumën rreth 38.000 Zloty (konvertuar rreth 8.840 euro ose 1.015.000 lekë).

⁵ <https://www.exchangerates.org.uk/PLN-EUR-spot-exchange-rates-history-2021.html>

TË DHËNA KONFIDENCIALE

a) **Gjendje cash:** 4.500 euro.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna e kryer në Krakov. Kursime nga paratë e prindërve, që mi kanë dhënë kur kam ardhur dhe gjatë kohës së studimeve në Krakov.

Trajtuar më sipër.

✓ Konstatohet: Gjendja cash është krijuar gjatë periudhës 2016-2023.

✓ Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.

b) **Llogari rrjedhëse:** Banka Revolut, me balancë në datë 31.12.2021.

Vlera: 0.80 euro. Mbyllur llogaria.

131. Nga nxjerrja e llogarisë në Revolut Bank, datë 16.06.2023, të përcjellë nga subjekti, konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 02.03.2023, në shumën 10.27 PNL (ose 2.3 euro).

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.

c) **Llogari rrjedhëse:** Banka Santander Bank Polska, me balancë në datë 31.12.2022.

Vlera: 13.300 Zloty (1 euro = 4.8 Zloty) ose 2.770 euro.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat shuma 890 euro.

HETIMI ADMINISTRATIV

132. Burimi i krijimit të kësaj llogarie, pra të ardhurat nga pagat nga punësimi i djalit Stiven Rizaj, janë trajtuar më sipër. Nga dokumentacioni justifikues i administruar në ILDKPI me inventarin nr.extra prot. datë 21.06.2023 dhe të analizuar nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nga nxjerrja e llogarisë në Santander Bank, datë 23.02.2023, konfirmohen të ardhurat nga paga për Stiven Rizaj, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën totale rreth 57.000 PNL (zloty).

133. Në lidhje me gjendjen e llogarisë të deklaruar, sipas statement bankar të Santander Bank, datë 23.02.2023, konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 30.12.2022, në shumën 13.239 PNL (2.760 euro).

134. Ndërsa, nga nxjerrja e llogarisë nga Santander Bank, datë 16.6.2023, konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 06.03.2023, në shumën 16.262 PNL (zloty) ose 3.388 euro.

✓ Konstatohet që llogaria është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2023.

✓ Ndryshimi midis gjendjeve të deklaruara dhe atyre të konfirmuara nga banka, vjen si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 31.12.2022, ndërsa konfirmimi bankës i përket datës 05.03.2023.

d) **Llogari rrjedhëse:** Santander Bank Polska, me balancë në datë 31.12.2022.

Vlera: 1.500 Euro.

Burimi i krijimit: Transferta nga ING Bank Slaski S.A, ku mbylla llogarinë rrjedhëse në Santander Bank Polska.

HETIMI ADMINISTRATIV

135. **Burimi i krijimit të llogarisë është trajtuar më sipër.**

136. Për të vërtetuar saktësinë e deklaramit të llogarisë në Santander Bank, u morën në shqyrtim:

- a. Nxjerrje llogarie në monedhën euro nga Santander Bank, datë 16.06.2023, ku konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 06.03.2023, në shumën 1.500 euro. Konfirmohet kreditimi i shumës në Qershor - Gusht 2021.
- b. Nxjerrje llogarie nga ING Bank, në emër të Stiven Rizaj (në gjuhën polake), ku konfirmohet gjendja e llogarisë në datë 30.01.2021, në shumën 3.000 euro dhe gjendja në momentin e mbylljes së llogarisë në datë 31.01.2021, shuma 0 euro.

✓ **Llogaria është krijuar gjatë periudhës 2021 -2023.**

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË:

137. Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit, ku arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

✓ **Ka bërë deklaramit të saktë, në përputhje me Ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**

✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**

✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**

✓ **Nuk është kryer deklaramit i rremë;**

✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

138. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramiteve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramiteve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

139. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- (ii) Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- (iii) Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

140. Subjekti i vlerësimit, z. Edmond Ali Rizaj, në zbatim të nenit 36, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 06.03.2023.

141. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

142. Në përputhje me nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti me nr.*** Prot., i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar **përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Edmond Rizaj.**

143. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- a. Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
- b. Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
- c. Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.
- d. Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.
- e. Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si më poshtë:
 1. Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
 2. Pyetjes nëse ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, i është përgjigjur me “Po”, duke dhënë detajet përkatëse.
 3. Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
 4. Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.

5. Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
6. Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
7. Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij të jetë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
8. Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
9. Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
10. Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
11. Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
12. Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
13. Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
14. Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të Ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
15. Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
16. Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
17. Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
18. Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
19. Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
20. Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

144. Po ashtu, subjekti ka nëshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

HETIMI ADMINISTRATIV

145. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së

Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, ku ka rezultuar si vijon:

146. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 01.06.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.

147. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 19.05.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Edmond Rizaj, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

148. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot., datë 25.05.2023; për subjektin vlerësimit Edmond Rizaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna/informacione të vërtetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
- Nuk kanë të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.

149. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 30.05.2023 dhe me shkresën “E paklasifikuar”, nr.*** prot., datë 30.05.2023; për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- a. Nuk kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.
- b. Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.
- c. Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- d. Nuk kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- e. Nuk kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale.
- f. Rezulton që, më datë 01.06.2021 janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shtetasin Edmond Rizaj, për “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal.
- g. Nuk kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.

- h. Nuk kanë të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS.
 - i. Nuk kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - j. Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.
- 150. Institucion ligjbatues** me shkresat “Sekret” datë 13.06.2023 dhe datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
- a. Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara.
- 151. Institucioni ligjbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 26.05.2023; bën me dije se për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- 152. Institucion ligjbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 10.07.2023, për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, bën me dije se:
- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35, të Kodit të Procedurës Penale.
 - d. Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
 - e. Rezulton që, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të jetë regjistruar Kallëzimi Penal nr. ***, viti 2021, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. **Marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal më datë 21.06.2021.**
- 153. Institucioni ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 07.06.2023, bën me dije se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin e vlerësimit.
- 154. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, bën me dije se:
- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 02.10.2022, e vlefshme deri më datë 01.10.2027. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
 - b. AKSIK nuk disponon rekorde për Shkelje Sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

155. Avokati i Popullit me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. *** Prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me Ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

156. Institucioni ligjzbatues, me shkresën Nr. *** Prot., datë 08.06.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm, apo anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit rezulton se:

157. Gjatë kontrollit të rregullsisë së plotësimit të formularit për Kontrollin e Figurës rezulton që, subjekti i vlerësimit Edmond Rizaj, ka pasqyruar në formular një rast për të cilin sqaron se, “...në vitin 2001 jam marrë i pandehur për “Fyerje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 239/1 i Kodit Penal Më datë 11.07.2001, i dëmtuari akuzues, ish-punonjësi i policisë E. A. ka deklaruar para gjyqtarit të çështjes, z. I. M. dhe prokurorit z. B. T., që heq dorë nga kallëzimi. Me vendim nr.552, datë 16.07.2001, gjyqtari vendosi pushimin e gjykimit të çështjes.

158. Pas korrespondencës së realizuar me Prokurorinë e Përgjithshme, e si rrjedhojë me të gjitha Prokuroritë pranë Juridiksionit të Përgjithshëm, prej tyre është përcjellë informacion vetëm për materialin kallëzues të regjistruar për aksidentin e ndodhur në vitin 2021, ndërsa për rastin e relatuar nga vetë subjekti i vlerësimit, nuk ka përcjellë asnjë informacion.

159. Në lidhje me referimin e vitit 2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bën me dije se:

Prokurori i çështjes në datë 14.06.2021, ka vendosur mosfillimin e hetimeve që kanë lidhje me kallëzimin penal nr. 6970, viti 2021, me arsyetimin ligjor se, “...duke qenë se nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor rezulton se dëmtimet e shkaktuar shtetases R.O., kanë sjellë humbje të aftësisë së përkohshme në punë në masën deri në nëntë ditë, konkludohet se nuk është konsumuar vepra penale e “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Kjo pasi mungon pasoja si element i domosdoshëm i anës objektive të kësaj vepre penale dhe konkretisht plagosja e lehtë e disa personave (dy ose më shumë personave)...”.

160. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se nuk u zbulua prania e substancave të testuara.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER PËR KONTROLLIN E FIGURËS:

161. Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit z. Edmond Ali Rizaj, ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.**
- ✓ **Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

162. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

163. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- b. Raportin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

164. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 46 pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit Edmond Rizaj, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. *** Prot., datë 30.06.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:

Punonjësi i Policisë, Edmond Rizaj, është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme, duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

165. Subjekti i vlerësimit, Edmond Rizaj, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit, në Drejtorinë Hetimore në Departamentin e Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

166. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij Ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit, nga viti 2018 e deri aktualisht, ka qenë pjesë e Policisë së Shtetit.

167. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. ***.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS, me numër ***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, (i ndryshuar), të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit.

168. Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin e arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe Performacës e konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucioneve të tjera mbikëqyrëse.

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

169. Të dhëna për Arsimimin:

- Arsim i Lartë - Akademia e Rendit Publik, viti 1988-1992.
- Master Studimi në Polici nga ICITAP PAMECA për “Programin për Drejtuesit e Lartë”, në periudhën Janar- Nëntor 2007.
- Mbrojtja e Gjuhës Italiane (nota 9) - Dëshmi, në Korrik 2007 në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

169.1 Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezultojnë se subjekti ka përfunduar arsimin e lartë. Në kuptim të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezultojnë se:

- ✓ **Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

170. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet

170.1 Gjatë karrierës së tij, rezulton se subjekti i vlerësimit ka marrë 2 (dy) certifikata për performancë të lartë në realizimin e detyrave, 3 (tre) medalje, konkretisht:

- Në vitin 1990 – Medalje e Shërbimit Ushtarak;
- Në vitin 2012 – Medalje Nderi;
- Në vitin 2017 – Certifikatë Karriere;
- Në vitin 2021 – Certifikatë për Shërbime të Dalluara;
- Në vitin 2022 – Medalje Argjendi nga Presidenti i Policisë së Republikës Çeke.

170.2 Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, të përcjella me raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se ai ka kryer trajnimet dhe specializimet, si më poshtë vijon:

Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji dokumentit
2001	Kurs për Krijimin e Bazës së të dhënave të Analizës Kriminale ICITAP	Certifikatë
2002	Kursi i Kriminologjisë të Organizuar dhe Terrorizmit Ndërkombëtar	Certifikatë
2002	Kursi Kualifikimit për Drejtuesit e Rolit të Lartë dhe Madhor.	Certifikatë
2005	Kurs në Gjeorgji	Certifikatë
2006	Për mbrojtjen e të dhënave/analizave operative dhe Strategjike	Certifikatë
2010	Provim i gjuhës italiane	Certifikatë

170.3 Krahas specializimeve/certifikatave të përmendura më sipër, subjekti ka deklaruar në Formularin e aftësive profesionale edhe një sërë trajnimesh/specializimesh të kryera brenda dhe jashtë vendit, gjatë gjithë karrierës së tij, (bashkëlidhur certifikatat) të cilat kanë shërbyer në formimin profesional të tij.

170.4 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

- ✓ *Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.*
- ✓ *Subjekti ka kryer trajnime/specializime të shumta në përputhje me funksionin që ushtron.*

171. Vlerësimet e punës

171.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit, për periudhën 2018-2022, nga ku janë administruar 4 (katër) vlerësime të aftësive individuale të punës (nga 5 (pesë) që duhej të ishin), si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për

performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar në të katër vitet me pikët maksimale për punën e kryer, si më poshtë vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2018 - 31/12/2018	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2019 - 31/12/2019	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2020 - 31/12/2020	“ska”	
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2021 - 31/12/2021	28 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022	100 Pikë	(shumë mirë)

171.2 Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë së në periudhën 2019- 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

171.3 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

171.4 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga Trupa e Vlerësimit, konkludohet:

- ✓ *Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.*
- ✓ *Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.*

172. Masat disiplinore

172.1 Referuar raportit të dërguar nga DPPSH ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, si dhe nga verifikimi i Trupës së Vlerësimit në sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018- 2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ *Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.*
- ✓ *Deklarimi i subjekti është i saktë.*

173. Ecuria në karrierë

173.1 Subjekti i vlerësimit, Edmond Rizaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 31 vitesh.

Nga verifikimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, subjekti Edmond Rizaj, ka ecurinë në karrierë, si vijon:

- 25.01.2021– Aktualisht – Drejtor i Drejtorisë së Hetimit për Krimin e Organizuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- 12.02.2018 – 24.01.2021 – Profesor në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Akademinë e Sigurisë.
- 28.04.2017 – 12.02.2018 - Këshilltar, Zyra Ndihmëse e Drejtorit të Policisë së Shtetit, DPPSH.

173.2 Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si me poshtë:

- Me Urdhrin Nr. 47/1, datë 17.06.2008 ka përfituar Gradën Drejtues, për periudhën 11.06.2008 – 31.05.2009.
- Me Urdhrin Nr. 49/1, datë 04.06.2009 ka përfituar Gradën Drejtues i Parë, për periudhën 01.06.2009 – aktualisht.

173.3 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të z. Edmond A. Rizaj, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, Trupa e Vlerësimit konkludon se **funksionet në të cilat është emëruar subjekti, si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

174. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit

174.1 Subjekti i vlerësimit, z. Edmond Ali Rizaj, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, nuk ka marr pjesë në ndonjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER

175. Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Edmond Rizaj:

- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 24.01.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 13.02.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Edmond Ali Rizaj, në përputhje me nenin 60 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Edmond Ali Rizaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Hetimit për Krimin e Organizuar, në Departamentin e Policisë Kriminale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 13.02.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Erjana PJETRI
Kryesuese

Ersa KARAJ
Relatore

Klevis DHIGOI
Anëtar

Shtojca 1: Pasqyra e analizës financiare për periudhën 1996-2023.

(në lekë)	1996-2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
A) PASIRI	0	1,621,991	0	408,128	0	0	0	0	933,523	0	0	0	0	0	0	0	0	0	666,930	0	0	0	0
Apartament me sip. *** m ² ndodhur që ****		1,621,991																					
Apartament me sip. *** m ² . Kontratë Dharimi				408,128																			
Bërge automjeti 01.05.2004									933,523														
Bërge automjeti 29.09.2009																							
Bërge automjeti 16.08.2019																						666,930	
Ndryshim likuiditet																							
B) DETYRIME	0	1,558,672	0	200,000	0	0	0	700,000	0	0	0	200,000	200,000	200,000	0	700,000	0	0	0	0	0	0	0
Kredim i apartament nga EKB (2002-1.3.2023)		1,558,672																					
Kredi Procredi dt. 21.05.2004				200,000																			
Kredi Raiffeisen Bank dt.06.2008-2013								700,000															
Kredi Raiffeisen Bank dt. 8.8.2012												200,000											
Kredi dt. 01.08.2013													200,000										
Kredi dt. 21.10.2014														200,000									
Kredi dt. 25.05.2016 për arsimim nga *** Bank																700,000							
D) TE ARDHURA	1,840,805	945,289	1,339,186	1,234,893	1,771,644	1,873,808	1,562,903	1,866,511	1,992,611	2,433,108	1,727,466	1,815,538	1,628,306	1,570,440	2,169,481	1,798,933	3,709,132	1,834,463	2,340,392	1,820,055	1,908,282	3,464,350	337,958
Te ardhura nga pushtimi i subjektit E.R	1,453,595	523,666	823,876	802,364	1,016,261	1,136,233	1,234,325	1,284,751	1,366,216	1,494,539	1,159,053	1,232,672	1,030,647	1,017,434	1,235,745	1,090,063	1,292,241	1,153,011	1,106,132	1,143,351	1,278,974	1,408,916	212,612
Te ardhura nga pjesemarrja në projekte																							
Te ardhura nga paga e bashkëshortes M.R	305,438	216,292	245,219	162,889	280,002	304,566	286,578	505,540	593,335	579,549	559,411	582,866	597,659	553,006	654,114	628,950	666,452	681,452	627,960	685,704	689,308	691,852	125,346
Te ardhura nga shpërblimet e bashkëshortes M.R	81,772	205,431	270,091	269,640	465,381	433,009	18,000	43,200	9,000	9,000	9,000												
Te ardhura nga pushtimi i personit që lidhur S.R															279,622	79,920							
Te ardhura nga bursa e personit që lidhur S.R. 2007-2010							24,000	33,000	24,000														
Te ardhura nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 65.8 m ² ndodhur që **** 03.04.2017																	1,750,439						
Te ardhura nga shitja e automvetesit Renault Laguna 2010										350,000													
Te ardhura nga shitja e automvetesit Opel Vectra 2019																					606,300		
Te ardhura nga shitja e automvetesit Volkswagen Jetta 2022																							993,990
E) SHPENZIME	1,388,155	332,836	343,236	495,045	627,648	541,248	1,005,312	708,798	1,115,243	1,115,243	1,115,243	858,423	915,979	1,286,418	1,185,535	1,491,374	1,126,709	1,181,722	1,243,519	1,256,948	1,117,543	1,100,160	183,360
Shpenzime vjetore jetke sipas INSTAT	1,324,836	280,836	280,836	351,045	442,848	442,848	942,912	546,480	853,008	853,008	853,008	558,192	558,192	944,568	953,487	940,740	898,375	953,388	995,868	1,018,968	981,888	1,037,760	172,960
Shpenzime kreditari apartament 2002-2027	63,319	52,000	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	62,400	10,440
Shpenzime pagësi Krede 2004 princpal + interesa				81,600	122,400	36,000																	
Shpenzime pagësi Krede .2008 + interesa								99,918	199,835	199,835	199,835	199,835	99,919										
Shpenzime Pagësi Krede 8.8.2012 + interesa									37,996														
Shpenzime Pagësi Krede 1.08.2013 + interesa														71,981									
Shpenzime Pagësi Krede 21.10.2014 + interesa															24,535	169,648	95,393						
Shpenzime shpërblimi për personin që lidhur S.R. =																							
Shpenzime pagësi Krede 25.05.2016- 2021																72,841	165,934	165,934	185,251	175,580	73,255		
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit																							
Mundësia për Karsim= Te ardhura +Detyrime - Shpenzime-Pasuri	452,650	1,001,884	1,997,834	2,529,554	3,673,550	5,006,110	5,563,701	7,421,414	7,365,289	8,683,124	9,295,347	10,452,463	11,364,789	11,848,811	12,832,757	14,140,316	16,722,739	17,375,480	17,905,423	18,377,529	19,228,268	21,592,458	21,747,056
CASH në lekë																							1,436,635